


RILEVIMI TOPOGRAFIK I PJESHEM I SHESHIT LUNGOMARE

Objekti : “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor ,Vlorë ”


SISTEMI KORDINATIV KRGJSH

SHKALLA 1: 1000



POZICIONI KADASTRAL

SHKALLA 1: 2500



REALIZOI :
EMRI_ERIS NDRUKAJ_
LICENCA NR _T.1287/1_
DATE _08.09.2020_
NËNSHKRIMI/VULA

STUDIM GJEOLOGJIK
PËR
“NDËRTIMIN E GODINËS SË PARKIMIT
NËNTOKËSOR DHE I PARKUT SHPLODHËS”
BASHKIA VLORE

Klient: BOE: “ARCHISPACE” Sh.p.k & “I RI” Sh.p.k & “SPHAERA” Sh.p.k	Pregatitur nga: GJEOKONSULT & Co Sh.p.k.
--	---

Tirane, Korrik 2025

Tabela përmbledhese

1-Hyrje	3
2- Qëllimi i studimit.....	3
3 - Objektivi i Punimeve	3
4 - Gjeomorfologjia.....	4
5 - Ndërtimi Gjeologo – Struktural i Zonës.....	5
6 - Kushtet hidrogeologjike	11
7 - Proceset gjeodinamike	13
8 - Punimet fushore	15
9 - Rezultatet e studimit në terren.	16
10 - Faktorët që ndikojnë në lëngëzimin e dherave	22
11 - Gërmimet e themelit dhe masat inxhinerike për stabilizimin e skarpateve	24
12 - Kushtet Gjeologjike të truallit në gërmime	Error! Bookmark not defined.
13 - Konkluzione dhe rekomandime	27

1-Hyrje

Në bazë të kërkesës për ndertimin e godines se parkimit me 2 kate nentoke dhe i parkut shplodhes”, Bashkia Vlore, u kryen testet DPT për studimin dhe vlerësimin gjeologo-inxhinierik në sekuencën depozicionale në sheshin e ndertimit te godines se parkimit. Për studimin e truallit u kryen testet DPT në 4 pika me thellësi DPT1 = 15m, DPT2 = 12 m, DPT3 = 13 m dhe DPT4 = 15m, u përpunuan të dhënat duke marrë parasysh ndërtimet dhe punimet e tjera përreth. Mbi bazën e vrojtimeve në terren dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara u arrit në konkluzionet fiziko-mekanike si dhe hartimi i raportit teknik për kushtet gjeologo-inxhinierike të këtij sheshi.

2- Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i karakteristikave fiziko-mekanike të dherave dhe shkëmbinjve që takohen në zonën ku ndodhet sheshi i ndertimit te godines se parkimit. Të dhënat e marra nga punimet fushore dhe ato të testit DPT i shërbejnë projektuesve për të realizuar projektin e zbatimit për këtë objekt.

Për realizimin e këtij raporti u krye studimi me testimet DPT në 4 pika të sipërfaqes se objektit, me thellësi DPT1 = 15m, DPT2 = 12 m, DPT3 = 13 m dhe DPT4 = 15m, në dherat aluvionale të fushes se Vlores, si dhe janë shfrytëzuar materiale të tjera studimore të fushës së gjeologjisë inxhinierike të kryera nga autorët e këtij raporti dhe nga autorë të tjerë në rajonin e Vlores, në afërsi të zonës në fjalë. Jane marre ne konsiderate te dhenat litologjike dhe karakteristikat fiziko – mekanike te pusit te shpuar me marrje kampioni, me thelleshi 11m, rreth 300m larg nga sheshi yne.

Gjithashtu janë marrë në konsideratë dhe materialet studimore të mëparshme dhe eksperiencia e specialisteve të vjetër të fushës, për zonën në fjalë dhe të gjithë rajonit të Vlores në përgjithësi.

3 - Objektivi i Punimeve

Raporti shqyrton çështjet të cilat janë të mbështetura me punimet gjeologjike sipas programit të miratuar nga porositësi dhe të zbatuar nga grupi i punës.

1. Janë rishikuar të gjitha punimet e mëparshme gjeologjike të kryera nga autorë të tjerë të cilat janë kryer për qëllime të tjera por kanë vlera njohëse.
2. Janë studiuar punimet gjeologjike të vjetra që janë kryer për zonën e rajonit, hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të zonës ku do të ndërtohen objektet e reja.
3. Janë kryer punime të ndryshme sipas programit të hartuar, por të kombinuar dhe me punimet ekzistuese të cilat janë shumë të rëndësishme për të kuptuar fenomenet gjeologjike që kanë ndodhur në zhvillimin e historikut gjeologjik të kësaj zone.
4. Një rëndësi të veçant kanë dhe testimet në in – situ, testet DPT të kryera në terren.

Raporti studimor shoqërohet me hartën gjeologjike dhe topografike në shkallë 1:25000, prerje gjeologo - litologjike të truallit të variantit të paraqitura nga projekti.

Për realizimin e këtij studimi janë kryer punimet e mëposhtme:

- a) Janë studiuar sekuenca depozicionale dhe litologjia e shtresave të dherave në zonën ku do të ndërtohet godina e parkimit me 2 kate nentoke dhe parku shplodhes.
- b) U krye interpretimi i të dhënave DPT test, të dhënave të laboratorit dhe hartimi i raportit përfundimtar.

Studimi është kryer konform standarteve bashkohore (Eurokodi – 7).

- ISO – 22475-1- Geotechnical investigation and testing.
- EN 1997 – 1 - Geotechnical designe.
- EN 1997 – 7 - Geotechnical testing (Ground investigation and testing).

4 - Gjeomorfologjia

Në këtë kapitull do të shtjellojmë përshkrimin e zonës ku shtrihet projekti për ndertimin e godines se parkimit me 2 kate nentoke dhe i parkut shplodhes”, Bashkia Vlore, format e relievit të sotëm, kushtet gjeologjike të formimit të këtij relievi. Do të bëhet përshkrimi i fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike të zonës.

Vendodhja e objektit dhe përshkrimi i relievit

Vendi ku ndodhet projekti për ndertimin e godines se parkimit me 2 kate nentoke dhe i parkut shplodhes”, Bashkia Vlore, në pjesen perëndimore të qytetit të Vlores. Sheshi i ndërtimit të objektit, për të cilën kryhet studimi Gjeologo-Inxhinierik, siç duket nga planimetria që shoqëron këtë studim ndodhet pranë rërës së plazhit.



Vendndodhja dhe Planimetria e objektit

5 - Ndërtimi Gjeologo – Strukturore i Zonës

Oligoceni i mesem (Pg²)

Depozitimet e Oligocenit të mesëm takohen në tre nënzonat tektonike (Beratit, Kurveleshit dhe Çikës), duke marrë pjesë në ndërtimin e kraheve të strukturave antiklinale dhe sinklinale.

Në rajonet e pjesës qendrore të zonës Jonike këto depozitime përfaqësohen nga fliş argjilo-ranor kryesisht ritem mesëm me shtresa gelqerori mikritik, biomikritik e turbiditik. Karakteristike dalluese është rritja e shtresave gelqerore nga lindja në perëndim jo vetëm si numër por edhe si trashësi dhe zvogëlimi i komponentit ranor, deri në zhdukje të tij përja e Lapardhës (antiklinali i Tragjasit). Ndërsa në nënzonen lindore të zonës Jonike këto depozitime përfaqësohen nga fliş ranoro-argjilor me vithisje nënujore e me shtresa të rralla gelqeroresh.

Oligoceni i sipërm (Pg³)

Depozitimet e Oligocenit të sipërm kanë përhapje më të kufizuar në krahasim me ato të Oligocenit të poshtëm dhe të mesëm. Ato marrin pjesë në ndërtimin e vargjeve sinklinale dhe vazhdimëve veriore të nënzonave të Beratit dhe Kurveleshit. Në përgjithësi të gjithë shtresat gelqerore në tavan kalojnë gradualisht në mergele argjilore. Nga lindja në perëndim verëhet dhe rritja e numurit të horizonteve vithises.

Në përgjithësi në pjesën e sipërme të Oligocenit të sipërm predominojnë ranoret të cilët hera-herës kalojnë në ranore masive.

Pra, siç shihet depozitimet e Oligocenit të sipërm pesojnë ndryshime të theksuara nga lindja në perëndim dhe nga jugu në veri.

Akuitaniani (N¹_a)

Depozitimet e Akuitanianit përhapen nga Saranda deri në Vlorë, duke mbushur kryesisht vargjet sinklinale. Këto depozitime në pjesën e poshtme përfaqësohen nga ndërthurje ranorësh të trashë deri masive me shtresa të holla argjilash e alevrolite. Në shtrirje ato pesojnë ndryshime të theksuara litologjike, duke kaluar hera-herës në fliş të hollë argjilo-alevrolito-ranore (krahu lindor i sinklinalit të Memaliajt, etj). Në vargun e Shushicës takohen dhe shtresa gelqeroresh detritike me material terrigjen e mergele. Karakteristike për depozitimet e pjesës së sipërme është prania e argjilave mergelore, të cilat gradualisht shtohen në prerje dhe që perkojnë me formacionin "Levani", i cili vazhdon edhe në Burdigalian.

Në teresi këto depozitime vendosen në vijuesmeri normale mbi ato të Oligocenit të sipërm.

Serravaliani (N²_s)

Në zonën Jonike depozitimet e Serravalianit, përhapen në vargjet sinklinale, kryesisht në ato të Memaliajt dhe Shushicës. Këto depozitime marrin pjesë në ndërtimin e kraheve dhe mbylljeve centriklinale e periklinale të rudhosjeve terrigjene.

Prerja litologjike e depozitimeve te katit Serravalian perfaqesohet kryesisht nga alternime ndermjet pakove te argjilave dhe ranoreve me linza e shtresa gelqeroresh lithotamnike.

Argjilat kane ngjyre gri te zbardhur ne siperfaqe, ndersa ne thyerje te fresket ngjyra e tyre eshte e kalter deri ne nuanca jeshile. Paraqiten ne formen e paketave me trashesi 2-5-15m. dhe rralle i takon si pako masive deri 30-50m.

Karakteristike dalluese e argjilave dhe alevroliteve te Serravalianit, eshte se ato ne disa rajone kane pamjen e shumengjyreshave.

Ranoret paraqiten me ngjyre gri te zverdhur deri kafe te çelur, kokerrimet deri kokerrmesem me trashesi 0.4 deri 0.7m. Ata ne mjaft rajone takohen ne formen e paketave disa metroshe, ne te cilat here here takohet makrofaune, bivalvoreve e gastropodeve.

Gelqeroret lithotamnike kane ngjyre gri ne bezhe, permbajne lithotamnie te shumta, dhe drejt tavanit kalojne ne gelqerore mergelore. Trashesite e gelqeroreve lithotamnike luhaten nga 2-3m deri 10-15m.

Plioceni (N₂)

Keto depozitime perhapen ne forme pullash te mbivendosura mbi shkembinjte e moshave te ndryshme ne zonen Jonike.

Kufiri transgresiv shenohet me gjetjen ne prerje te shtresave konglomeratiko-brekcioze me trashesi deri 5-7 m. Karakteristike eshte gjetja me shumice e coprave qoshore dhe gjysem te rrumbullakosura te çimentuara dobet qe kane madhesi nga disa cm deri 15-20cm.

Ne shtrirje takohen ndryshime litologjike si dhe verehet fenomeni i pykezimit te shtresave ranore. Shperndarja e materialit trashaman eshte shume e çrregullt. Me siper ne prerje vijojne shtresa ranoro-gravelitike me çimentim te dobet deri me pamje rerore. Kane ngjyre kryesisht te zverdhura. Ato vendosen ne rajonin e Himares mbi depozitimet e Jurasikut, ndersa ne Rradhime mbi depozitimet e Burdigalianit.

Nga ana litologjike keto depozitime perfaqesohen nga dy pako me karakteristika te ndryshme litologjike te ndareshme ne siperfaqe dhe thellesi, qe vendosen me njepasnjeshmeri normale dhe shoqerohena me treguesit zonal biostratigrafik te tyre.

Brenda trashesise se plote pliocenike, ne Ultesiren Adriatike veçohen dukshem dy formacione litostratigrafike te njojtura me emertimet formacioni “Helmasi” dhe “Rrogozhina”.

Plioceni i poshtem (N¹_{2h})

Depozitimete e formacionit "Helmasi". fillojne me shfaqjen ne prerje te shtresave ranore dhe konglomerateve te pangopur, qe percaktojne dyshemene e tij dhe njekohesisht shenojne pranine e transgresionit pliocenik.

Argjilat predominojne ne prerje, jane gri hiri deri ne te kalterta, te buta deri ne kompakte, here-here shume mikore.

Pliocen i mesem (N²_{2rr})

Takohet ne te gjithë Ultesiren Adriatike. Ne prerjet e plota ne Pliocenin e mesem perfshihet, pjesa me e siperme e formacionit Helmasi dhe teresisht formacioni “Rrogozhina”.

Depozitimet e formacionit “Rrogozhina” vendosen mbi pakon argjilore te formacionit “Helmasi” dhe kane maredhenie normale me te. Ato kane perhapje ne te gjithë shtrirjen e Ultesires Adriatike

Ne konglomeratet takohen zaje te rumbullakosur dhe gjysem te rumbullakosur te shkembijnve magmatike dhe sedimentare. Masa çimentuese e konglomerateve e zajeve eshte argjilo-alevrito-ranore, gravelitike dhe e tipit bazal. Ne ranoret dhe konglomeratet e ketij formacioni gjenden shtresezime te pjerrta e te kryqezuara, karakteristike e trashesise te formacionit mollasik.

Depozitimet e Kuaternarit (Q)

Holoceni (Qh2)

Depozitimet e Holocenit kanë përhapje të gjerë në Shqipëri. Në këtë seksion takohen pothuaj të gjitha tipet gjenetike si ato kontinentale, ato ndërmjetëse dhe ato detare. Më të përhapura janë depozitimet aluviale, të cilat kanë mbushur pothuaj tërësisht Ultesirën Adriatike nga Mbishkodra deri në afërsi të Vlorës. Përhapje të konsiderueshme kanë edhe tipet e tjerë gjenetike, si ato proluviale, eluviale e deluviale, kënetore e liqenore, lagunore e detare, të cilat më poshtë do ti përshkruajmë më hollësisht.

a. Depozitimet aluviale

Ato kanë përhapje të gjerë në zonat e ulta, në rrjedhjet e mesme të lumenjve, shpesh edhe në rrjedhjet e sipërme. Në rrjedhjet e mesme dhe të sipërme ato formojnë depozitimet e taracave të shtratit si dhe depozitimet e sotme të shtratit, të cilat i përkasin Holocenit të vonshëm. Këto depozitime kanë qenë dhe janë objekt i shfrytëzimit të inerteve, pasi kryesisht përfaqësohen nga zhavore, zhure dhe rëra.

Përhapjen më të madhe depozitimet aluviale e kanë në fushe e Vlorës, e tjera, të cilat kanë marrë edhe emërtimin fushat aluviale. Ato kanë trashësi nga disa metro deri në 20-30 m të vendosura po mbi depozitimet aluviale të Pleistocenit, të përfaqësuara kryesisht nga zhavoret. Depozitimet aluviale të Holocenit vazhdojnë në pjesën e poshtme të luginës së Vjosës, nga Levani e deri në afërsi të grykëderdhjes. Depozitimet e Holocenit vendosen mbi depozitimet e freskores aluviale të Pleistocenit, e cila futet thellë në detin Adriatik.

Në përgjithësi depozitimet e Holocenit të formuara nga prurjet e fuqishme të lumenjve kryesorë të vendit tonë kanë përbërje të imët, të përfaqësuara nga rëra të imta, alevrite dhe argjila me trashësi që luhatet shumë, por që nuk i kalon 20-30m. Karakteristikë është, që në brendësi të kontinentit vendosen mbi zhavoret e Pleistocenit të formuar po nga këta lumenj dhe në afërsi të vijës bregdetare ato vendosen mbi depozitimet detare të Holocenit. Ky ka qenë një nga argumentet për të ndarë dy katet e Holocenit në fushat aluviale të Adriatikut.

Nen keto depozitime takohen depozitimet e Neogjenit qe perbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyre gri me cimentim te dobet deri mesatar, pjesa e sipërme e ketyre depozitimeve eshte e

perajruar. Keto depozitime dalin ne siparfaqe ne kodrat e Kuzbabase ne Lindje te sheshit te ndertimit.

b. Depozitimet proluviale

Keto depozitime perhapen gjeresisht si ne zonat e ulta ashtu dhe ne zonat e larta, pergjithesisht perfaqesojne depozitimet e formuara nga perrenj qe derdhen ne luginat e lumenjve kryesorë, te perrenjve qe pershkojne zonat fushore dhe ato bregdetare. Kryesisht ato jane te sotme dhe kanë formën e freskoreve deri ne formën e koneve te rrjedhjeve .

Vlen te theksohet qe shpesh keto formime ndërthuren me depozitimet aluviale.

c. Depozitimet, deluviale dhe kolumviale

Ato i takojme pothuaj ne te gjitha kembet e shpateve te kodrave dhe maleve, sidomos ne ato qe perbehen nga terrigjene dhe flishore (relativisht te pa qendrueshem ndaj agjenteve atmosferike) Mjaft te perhapura jane formimet eluviale dhe deluviale, te vendosura ne rrafshinat malore dhe pothuaj ne te gjithe shpatet. Nga formimet eluviale ne ato deluviale kemi gjithmonë kalime te doradorshme. Vlen te theksohet se keto tipe formacionesh nuk jane vleresuar, pasi ato ne rilevimet gjeologjike jane konsideruar si pengese dhe kudo jane zhveshur. Keshtu qe edhe te dhënat per formimet eluviale dhe deluviale, bile dhe per formacionet e tjera te Kuaternarit jane te kufizuara.

d. Depozitimet aluvialo - kënnetore

Keto depozitime takohen kryesisht ne zonat fushore qe jane pershkuar e pershkohen nga lumenj te ndryshem. Te tilla depozitime do ti gjejmë ne rajonin e Nartës etj.

Keto i takojne kryesisht Holocenit te vonshem, kur me sa duket keto rajone permyteshin vazhdimisht nga lumenjtë, duke u kthyer keshtu ne këneta. Ato perfaqesohen nga ndërthurje alevritesh, rërash te imta, llum argjilor me material më te trashë, zhure e zhavore. Zona ku eshte bere studimi ben pjese ne depozitimet aluvionale te gjirit te Vlores keto depozitime kane nje trashesi 40.0-45.0 m.

e. Depozitimet lagunore

Ne zonën litorale te detit Adriatik jane te perhapura depozitimet lagunore, qe jane depozitime ndermjet atyre kontinentale dhe detare. Ato takohen pranë deltave te lumenjve kryesorë te vendit tone. Karakteristika kryesore e këtyre depozitimeve është mungesa ne to e lëndëve organike dhe prania e faunës detare (te ujrave te kripura) Ato perfaqesohen nga ndërthurje shtresash argjilore, alevritore e rërash. Kanë trashësi deri ne 10-15m.

Si depozitime ndermjetese percaktohen dhe depozitimet deltore, te cilat aktualisht i shohim ne deltat e lumenjve kryesorë te vendit tonë ne mënyre te veçantë ne atë te Semanit, Shkumbinit dhe Vjosës.

f. Depozitimet detare

Ne vendin tonë kanë perhapje pergjatë bregdetit Adriatik nga Shëngjini deri ne Vlorë. Ato dalin ne sipërfaqe pranë vijës bregdetare deri ne disa qindra metra ne drejtim te kontinentit, pastaj ato shtrihen poshtë depozitimeve lagunore, aluviale e kënnetore. Ato kanë trashësi nga disa metra deri

në 100m në drejtim të detit. Përfaqësohen kryesisht nga rëra të madhësive të ndryshme. Me depozitimet detare janë të lidhura dhe shkrifërimet detare të plazheve të sotme, por edhe ato të mbuluara në brendësi të kontinentit.

Vlen të theksohet që në fillimet e Holocenit të vonshëm (rreth 5 000 vjet me parë) deti Adriatik kufijtë i ka patur më të shtrire.

Tektonika

Kjo zone përfshin strukturat me perendimore të zonës Jonike që zbulohen në sipërfaqe. Karakteristike dalluese e saj është prania në pothuajse të gjitha strukturat e litofacies së “dolomiteve dhe gelqeroreve me alge” të Liasit të poshtëm - të mesëm, si dhe e litofacies “ammonitiko rosso” të Liasit të sipërm (Toarian), në vend të shisteve me possidonia që takohet në pjesët e tjera të zonës Jonike.

Në pjesën jugperendimore kontakton tektonikisht me zonën tektonike të Sazanit, duke u mbihedhur drejt perëndimit e duke maskuar plotësisht zonën e Adriatikut Jugor.

Me në veri, si rezultat i pranisë së shkeputjeve tërthore, si ajo e Korfuz-Borshit, etj., dhe kombinimit të tyre me ato gjatësore, vëhet reduktimi hap pas hapi i kësaj nënzona dhe i gjithë zonës Jonike. Kështu në veri të Orikumit mbihypja zvogëlohet dhe *çlirohet* njësia me perendimore e saj (brenda territorit tonë), sinklinali i Dukatit. Të dy krahët e sinklinalit nuk vërehen qartë, ato nderlikohen në lindje nga shkeputja perendimore e vargut antiklinal të Çikës që mbihypen drejt perëndimit dhe në perëndim nga shkeputja e krahut lindor të malit të Kanalit që ka dukuri mbihypje drejt lindjes.

Në pjesën veriperendimore në mbihypjen e vargut antiklinal të Çike - Tragjasit interpretohet prania e një zone të ngritur që perkon me ngritjen e Vlores.

Antiklinali i Çikës përfaqëson një strukturë me permasa të mëdha (30x6km.), me amplitudë rrudhosje 4-5km. dhe mbihypje drejt perëndimit mbi 10km., duke maskuar krejtësisht sinklinalin e Dukatit dhe një pjesë të zonës platformike.

Në veri nëpërmjet një qafe ndarese të komplikuar dhe me shkeputje tektonike (Qafa e Shengjergjit), ky varg antiklinal vazhdon me antiklinalin e Tragjasit me dimensione 24 x 8km. Edhe në këtë antiklinal spikatin shumë bukuri pushimet stratigrafike brenda prerjes karbonatike.

Ulsesira Adriatike ndodhet në pjesën qendrore e veriperendimore të Albanideve të jashtme, në buzën e orogjenit në kontakt me platformën Adriatike. Ajo përfaqëson një ultesirë paramalore që shtrihet mbi zonat e Sazanit, Jonike, Kruja dhe basenit të Adriatikut jugor. Në pjesët anësore, sidomos aty ku vendosen mbi orogjenin depozitimet molasike të ultesirës vendosen transgresivisht mbi vazhdimin e strukturave të zonës Jonike (Cakran, Kreshpan, Patos-Verbas, etj.) dhe të zonës Kruja (sinklinali i mbivendosur i Tiranës). Në pjesën qendrore ku ajo vendoset mbi zonën e Adriatikut Jugor, përgjithësisht pranohet shuarja e mosperputhjeve dhe mardhenie suksesive të depozitimeve.

Në rajonet jugperendimore, depozitimet molasike të Ulsesirës, duke filluar nga ato të Burdigalianit e më tej, vendosen transgresivisht mbi depozitimet karbonatike të zonës platformike të Sazanit. Molasat e mbuleses fillojnë nga Seravaliani, duke u ndjekur më lart nga Tortonianit, Mesiniani dhe Plioceni dhe së fundi edhe nga Kuaternari. Një rrudhosje e lehtë ndodh në fund të Miocenit. Në fillimin e Pliocenit, fillon tërheqja dhe zhytja e ultesirës, shoqëruar me grumbullime të fuqishme

(disa km., te sedimenteve te karakterit kryesisht konglomeratik ne buzen lindore (Formacioni Rogozhina) dhe te karakterit me argjilor ne buzen perendimore (Formacioni Helmasi"). Nga fundi i Pliocenit nga kompresioni i fuqishem ndodhi rrudhosja perfundimtare e ultesires ne te cilen u formuan strukturat rrudhose e shkeputese te saj.

Ne fund te Pliocenit, pasi u formuan strukturat e mesiperme vazhdoi ngritja e strukturave pozitive edhe ne Kuaternar dhe zhytja e sinklinaleve ndarese qe u mbushen me depozitime te moshes ne fjale.


Ne zonen detare, pra pjesen me perendimore te Ultesires, molasat mbivendosen mbi zonen tektonike te Sazanit. Te dhenat e marra kohet e fundit nga punimet sheshore seizmike detare sqarojne plotesisht maredheniet midis zones platformike dhe zonave te tjera me ne lindje.

Ne pergjithesi verehet nje zhytje graduale e platformes karbonatike drejt lindjes nepermjet shkeputjeve normale. Nga te dhenat e puseve te shpuar ne det, si ne zonen tone detare dhe ne zonen italiane, rezulton se depozitime me te vjetra qe kontaktojne transgresivisht mbi gelqeroret platformike jane ato te Burdigalianit.

Strukturat ne pjesen jugore (Himare) paraqiten ne forme monoklinale e me ne veri ne forme hundesh strukturore e antiklinale te mirefillte.

Nder ngritjet me te rendesishme qe reflektohet dhe ne nivelin e Pliocenit jane ato te Zvernecit, Adriatiku-1, Adr-2, Adr-5, etj.

Keto struktura jane pergjithesisht te qeta te krijuara si rezultat i fazes postpliocenike e cila me sa duket ka patur ndikim te vogel. Depozitimet neogjenike sipas edhe te dhenave te puseve te shpuar ne det, duke filluar nga perendimi ne drejtim te lindjes vendosen shkalle-shkalle transgresivisht mbi gelqeroret e Krete-Paleogjenit nga ato me te rejat Messiniani deri ne Burdigalian e me te vjetra, duke kaluar gradualisht drejt lindjes ne prerje suksesive, poshte Ardenice-Divjakes, ku me sa duket ajo unifikohet me zonen e Adriatikut jugor.



Harta gjeologjike K-34-123-D-b (Vlore)

6- Kushtet hidrogjeologjike

Nga studimet e kryera ne zonen e Vlores (nga matjet e kryera ne shpimet per disa vite ne punimet e ndryshme qe autoret kane kryer per kete zone) rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte i shume i ndryshem. Autoret e ketij studimi kane shfrytezuar te gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e reja ne to jane kryer matje ne disa kohe gjate gjithë periudhes se studimit dhe rezulton se ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshte shume afer siperfaqes se tokes (-0.50 m).

Ne dimer ky nivel eshte me afer nga siperfaqja e tokes natyrore 0.20 m nga niveli i siperfaqes se tokes.

Mbeshtetur ne ujepershkueshmerine e formacioneve qe ndertojne zonen e studimit veçohen komplekset e meposhtme ujembajttese:

- Kompleksi ujembajtes karbonatik.
- Kompleksi ujembajtes flishor argjilo - alevrolito – ranor.
- Kompleksi ujembajtes i kuaternarit.

Litogjikisht rajoni në studim përbëhet nga:

- a. ***Shkëmbinjtë karbonatik*** të strukturave antiklinale, që paraqiten pakot organogjeno-coprizore, pelitamorf te kretes Cr₁e Cr₂ paleocen (Pg₁) e eocen (Pg₂).
- b. ***Shkëmbinjtë terrigjen*** që paraqiten depozitimet e flishit argjilo-ranor me moshë Oligoen i poshtëm e i mesëm (Pg₃¹, Pg₃², N₁^{1b}).
- c. ***Shkëmbinjtë aluvional, deluvional e proluvional*** që mbivendosen transgresivisht mbi gëlqeror e flish me moshë Quaternare (Q_{4al}, Q_{4dl} e Q_{4prl}).
- d. ***Kompleksi ujembajtes karbonatik*** te zones Vlores nderton burimet e shumta te zones. Në kontakt te gelqeroreve te kesaj zone me depozitimet flishore dalin burime uji. Ato dalin edhe ne fundin e luginave karbonatike si burime karstike. Permendim ketu burimet e Ujit te Ftohte qe dalin ne kontakt te flishit me gelqeroret e strukturese se Cikes e Tragjasit. Ne siperfaqe të ketij kompleksi në zonen e studimit dallohen te gjitha format karstike duke filluar nga fusha në shpella karstike. ***Objekti Ujimbajtes Karbonatik (Cr1, Cr2, Pg1 - Pg2)*** Ne kete objekt ujembajtes, perfshihen ujrat gelqerore te Paleocenit-Eocenit (Pg1-Pg2). Depozitimet e ketij objekti ndertojne pjesen e siperme te kompleksit karbonatik dhe ekspozohen ne siperfaqe ne te gjitha strukturat antiklinale te rajonit.

Depozitimet e ketij objekti fillojne me gelqeroret porcelanik dhe vazhdojne me gelqeroret coprizor, mikritike, pelitomorf, mergel si dhe pakon kalimtare.

Keto formacione pershkohen nga dy sisteme carjesh, sistemi meridional dhe normal shtresezimit, me hapsire boshe 2-20 mm. Carjet ne siperfaqe jane te eroduara, te shpelara dhe te karstifikuara. Veprimtaria eroduese e karstit, ne siperfaqe eshte shume e avancuar, duke krijuar forma te ndryshme relievi: gishteze, vrime, brinje dhe gropezime te gjera te veprimtarise karstike te shplara dhe te gerryera. Sistemet e çarjeve (me teper gjate shtresezimit dhe renies se formacioneve) zgjerohen dhe futen ne thellesi ne formen e korridoreve, kavernave karstike me çfaqje te tyre ne zonen e ushqimit.

Zona e ushqimit dhe furnizimi me uji i burimeve te fuqishem karstik, qe lidhen me keto korridore, apo kolektor te medhenj ujembajtes, behet per llogari te reshjeve atmosferike, ne rruge te gjata dhe te thella qarkullimi, nepermjet fushave dhe rrafshnaltave karstike me siperfaqe ujembledhese relativisht te medha. Keto ujra me ane te rrjetit te dendur te çarjeve, percillen per ne thellesi, duke u grumbulluar keshtu ne kolektoret dhe rezervuarin ujembajtes nentokesore.

Nga studimet hidrokimike rezulton se ne pergjithesi ujerat e burimeve te ketij kompleksi karbonatik sipas klasifikimit te Sulinit, jane te tipit bikarbonat kalciumi ose kloro kalcitik me mineralizim te pergjitheshem 0.250-0.420 g/l.

Kompleksi Ujmbajtes flishor (Pg₃¹, Pg₃², N₁^{1b})

Ne kete object perfshihen ujrat e depozitimeve terigjene te flishit ranoro – argjilor, ku ranoret masiv dhe shtrese trashe krijojne kushte per depozitim e ujrave dhe levizjen e tyre brenda kolektoreve

ranor, te kurthezuar nga shtresat argjilore midis tyre. Keto ranore furnizohen me uji nga reshjet atmosferike ne zonat e ekspozuara ne siperfaqe, dhe burimet jane me prurje te vogla 0,1 – 1 l/s.

Komplekset Ujmbajtese aluvional, deluvional e proluvional te Quaternare (Q_{4al}, Q_{4dl} e Q_{4prl})

Keto depozitime jane te kufizuara ne rajon. Megjithate ato kane kontributin e tyre ne rezervat ujore. Puset e shpuar per kete qellim japin sasira te vogla uji.

7 - Proceset gjeodinamike

Ndonjehere rreziqet nuk jane te dukshme derisa te vihen ne dukje. Te gjitha rreziqet gjeologjike (gjeohazards) mund te konsiderohen te fjetura derisa te shkaktohen.

Kur ndodh rreziku, atehere mund te quhet ngjarje, aksident, emergjence, incident ose fatkeqesi. Studimi dhe monitorimi i rreziqeve gjeologjike na ndihmon te pergatitemi me mire dhe t'u pergjigjemi ketyre ngjarjeve gjeologjike kur ato ndodhin.

Gjeo-rreziqet mund te jene tipare te vogla qe kane ndikim vetem ne zone e tyre lokale, si p.sh. nje rreshqitje e vogel dheu qe bllokton pjeserisht nje rruge ose gjurmë, deri te tërmetet e medha qe prekin qytete te tere. Ato gjithashtu mund te jene ngjarje shume te medha qe kane nje ndikim te gjerë, si cunami i madh. Proceset gjeodinamike ne zone e studimit lidhen ngushte me energjine e brendshme dhe energjine e jashtme. Me energjine e brendshme lidhet tektonika dhe neotektonika ndersa, me energjine e jashtme lidhet tjetërsimi, rreshqitjet dhe erozioni.

Fenomenet me te dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike qe vërehen ne kete zone jane:

- Rreshqitjet e dheut
- Konsolidimi depozitimeve te dherave
- Erozioni
- Fenomeni i tjetërsimit te shkëmbinjëve
- Tërmetet (risku sizmik)

6.1 Rreshqitjet e dheut - është lëvizja e dheut, shkëmbinjve dhe mbeturinave në një shpat. Rreshqitjet e dheut shpesh ndodhin si pasojë e fatkeqësive të tjera natyrore, si tërmetet, shpërthimet vullkanike, dhe përmytjet (rreshjet). Këto depozitime përbëhen nga shtresa suargjilash dhe argjilash me përmbajtje lëndësh organike dhe copa e blloqe nga shkëmbi rrënjësor. Mbulesa deluvialo-eluviale e krijuar nga procesi i tjetërsimit (erozioni) të shkëmbinjëve është vendosur mbi formacionin rrënjësor. Nga ana jonë është treguar vëmendje e veçantë për të vlerësuar qëndrueshmërinë natyrore te shpatit dhe mbasi të ndërhyhet me punimet e ndërtimit. Edhe në rastin e gërmimeve të themeleve, pjerrësia e skarpateve ndikon në qëndrueshmërinë e rreshqitjen e dherave.

6.2 Konsolidimi depozitimeve te dherave - është i dukshëm tek formacionet aluvionale dhe deluvionale qe përbëhen nga argjilite, alevrolite, rëra dhe zhavore, të cilët janë depozitime të reja, me çimentim të dobët argjilor. Aluvionet nën veprimin e ngjeshjes dhe prezencën e ujrave nëntokësor transformohen në depozitime të teracave lumore. Është e rëndësishme që koha e konsolidimit dhe ndryshimi i volumit (uljet e trashësisë për shkak të ngjeshjes së tyre) duhet të meren parasysh në llogaritjet konstruktive të objekteve.

Shtresat e argjilave konsolidohen nën veprimin e ngarkesave për një kohë relativisht të gjatë, për

vet ndërtimi strukturor mineralogjik të argjilave që ka në përberje ujin në tre forma: në hapsirat midis peletave (uji i filtrueshëm), uji tensioaktiv që vesh peletat, dhe uji në përbërjen molekulare të argjilave (metamorfizimi i argjilave nga montmorillonit në kaolinit). Prandaj gjithë ky proces metamorfizues që të arijë konsolidimin e largimin e ujit kërkon kohën e ngarkesën e vet. Prezenca e lëndës organike gjithashtu e vështirëson dhe zgjat kohën e konsolidimit sepse lënda organike dekompozohet me kalimin e kohës, e gjatë dekompozimit ajo ndryshon volumin e saj dhe sjell ulje të menjëhershme të cilat ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e objekteve të vendosura mbi këto shtresa. Objekti që studiojmë ndodhet mbi depozitime të shpateve të kodrave, ku thellësia e ujrave nën tokësor ndodhet thellë.

6.3 Erozioni - është i lidhur me kushtet klimaterike dhe përbërjen litologjike të shkëmbinjëve që ndërtojnë zonën e studimit. Erozioni në zonën e studimit është sipërfaqësor dhe linear.

Erozioni sipërfaqësor - kap sipërfaqe të mëdha të flishit e mollaseve që karakterizohet nga mungesa e bimësisë, nga zona të çveshura dhe intensitet të lartë erozioni. Kjo bën të mundur që të krijohen në këto zona rrjedhje apo rrjedhje-rreshqitje sidomos në paketat argjilore.

6.4 Tjetërsimi është fizik dhe kimik - Tjetërsimi fizik është shprehur në shkëmbinjtë ranorike, trashësia e tyre arrin deri në 1.0 m. Ndërsa tjetërsimi kimik shprehet me dukurinë e karstit të zhvilluar në ranore e konglomerate. Karsti është i zhvilluar në formë të ndryshme në struktura të ndryshme. Burimet karstike dalin edhe në bazën e sotme erozionale brenda masivit.

6.5 Tërmetet(risku sizmik)dhe neotektonika - Prishjet neotektonike shprehen me sizmicitetin e zonës. Sizmiciteti lidhet me vijat sizmogjene me drejtim VP - JL, që i japin zonës së studimit tërmete me intensitet mesatar në ball MKS-64, në bazë të rajonizimit sizmik të Republikës së Shqipërisë.

Modeli i përdorur sizmotektonik (Sh.Alia}, E.Sulstarova)

Nga konsideratat e regjimit tektonik të sotëm, nëngrupi i katalogut shqiptar, sizmiciteti rajonal u nda në 9 burime sizmike (Sulstarova et al., 2005), së bashku me një zonë burimore për të modeluar tërmetet në rajonin e Shkupit (Talaganov et al., 2003).

Pra, zona burimore sizmike të dalluara në zone dhe rrethinat e saj janë si më poshtë:

1. Zona Peri - Ultësirë Adriatike (PL) me $M_{max} = 7.0$
2. Zona e Bregut Jon (IC) me $M_{max} = 7.0$

Karakteristikat kryesore të Zonave të Burimeve Sizmike (Sh.Alia), E.Sulstarova)

1. Zona Ultësira Peri - Adriatike (PL) është një zonë bregdetare që shtyn thyerjet shtytëse pas Pliocenit, nga veriu deri në N-NW, të cilat priten nga thyerje të rralla të goditjes me tendencë E-NE. Përgjatë zonës së thyerjes të Ultësirës Peri-Adriatike, janë regjistruar tërmete të shumta të forta, si më poshtë: Mars 1273 Ms = 6.6; 17 tetor 1851 Ms = 6.6; 17 dhjetor 1926, Ms = 6.2; September1, 1959 Ms = 6.2; 18 mars 1962 Ms = 6.0. Studimet mikrotektonike dhe zgjidhjet e mekanizmave fokale të tërmeteve tregojnë se kjo zonë thyerjeje është tashmë në regjim të zhdrejtë të shtypjes. Tërmetet e ardhshme në Ultësirën Peri-Adriatike mund të ndodhin me $M_{max} = 7.0$.
2. Zona Bregdeti Jon (JC) është një zonë bregdetare që përmban thyerje të pastra të shtytjes me shtypje të para-pliocenit VP-strikeIiking, të cilat priten nga thyerje të rralla strikeIike-rrëshqitje.

Kjo zonë thyerjeje është ende aktive dhe sizmogjene. Përgjatë tij janë regjistruar tërmete të shumta të forta, ndër të cilat mund të përmendim: 358 Ms = 6.6; 1153 Ms = 6.6; 16 prill 1601 Ms = 6.6; 1 janar 1674 Ms = 6.6; 5 prill 1701 Ms = 6.6; 20 shkurt 1743 Ms = 7.0; 10 dhjetor 1813 Ms = 6.6; 19 qershor 1823 Ms = 6.6; Januruy 19, 1833 Ms = 6.6; 12 tetor 1851 Ms = 6.6; 2 janar 1866 Ms = 6.6; 4 dhjetor 1866 Ms = 6.6; 11 shkurt 1872 Ms = 6.6; 14 qershor 1893 Ms = 6.6; 26 nëntor 1920 Ms = 6.4 (Sulstarova 2005). Studimet mikrotektonike dhe zgjidhjet e mekanizmave fokale të tërmeteve tregojnë se zona e thyerjes së shtytjes Jon është tashmë në regjim shtypjeje me tendencë JP-VL (Aliaj, 1988; Sulstarova, 1986; Muco, 1994). Tërmetet e ardhshme mund të ndodhin në zonën e thyerjes bregdetare të Jonit me $M_{max} = 7.0$.

8 - Punimet fushore

Për përcaktimin e kushteve të detajuara gjeologjike e gjeoteknike të zonës, në bashkëpunim me grupin e projektimit, është hartuar program i cili respektohet nga “Gjeokonsult & Co” Sh.p.k.

Qëllimi i Punimeve Fushore

Punimet fushore kanë për destinacion të përcaktojnë në terren karakteristikat e formacioneve gjeologjike në zonën ku do të ndërtohet objekti i marrë në studim. Në fazën e punimeve fushore janë prodhuar hartat gjeologjike të shkallëve të ndryshme. Në këtë fazë do të identifikohen dhe fenomenet negative fiziko - gjeologjike që janë prezente në këtë zonë.

Inspektimi i Punimeve në Terren

Të gjitha punimet fushore si rilevimet gjeologjike, gërmimet, zhveshjet natyrore dhe punimet për testet DPT për klasifikimin e dherave të bazamentit të objekteve do të kryhen nën mbikqyrjen e inxhinierëve të kompanisë “Gjeokonsult & Co” Sh.p.k. dhe në të shumtën e rasteve janë inspektuar nga përfaqësuesi i porositësit. Mbi bazën e të dhënave të korektuara, përshkrim fushor dhe rezultateve litologo - stratigrafike të kryera është bërë përpilimi i raportit gjeologjik.

Planifikimi i thellësisë së testeve në terren

Para fillimit të punës në terren është bërë studimi i draftit të projektit të detajuar mbi bazën e të cilit janë projektuar punimet fushore.

- a) Për të vlerësuar truallin janë studiuar sekuenca depozicionale dhe litologjia e shtresave të dherave të formacionit gjeologjik në zonën e objektit, në brigjet detit.
- b) Të gjitha punimet në fillim do të aprovohen nga grupi i projektimit.

9 - Rezultatet e studimit në terren.

Në këtë kapitull do të trajtohet interpretimi i rezultateve të studimit gjeologjik dhe gjeoteknik që është kryer në këtë zonë.

9.1 Kushtet gjeologo-inxhinjerieke të truallit.

Bazuar në të dhënat e marra në terren janë bërë ndarjet e shtresave sipas ndodhjes së objektit në Bashkinë Vlore. Nisur në skemën e objektit janë kryer testime për studimin e truallit me testet DPT, e cila bazohet në reagimin e konit të penetrimit gjatë zhytjes në dhera nga goditjet standarte NDPT në thellësi DPT1 = 15 m e DPT2 = 12 m, DPT3 = 13 m dhe DPT4 = 15m, dhe është vlerësuar sekuenca depozicionale duke ndarë shtresat sipas litologjisë dhe karakteristikave gjeoteknike të tyre.

Thellësia e ujit është kapur tek DPT1 = 3.8 m. Në bazë të studimit të kryer në sheshin e ndërtimit theksojmë se ka kushte te komplikuara Gjeologo-Inxhinjerieke për ndërtime.

9.2 Përpunimi i testit të Provës Penetrometrike Dinamike.

Me kërkesë të investitorit u kryen prova penetrometrike dinamike për të karakterizuar nga pikëpamja gjeoteknike truallin. Janë kryer tre prova me Penetrometër Dinamik Pagani TG 30-20 të prodhuar nga Pagani Geotechnical Equipment, Piacenza.

Karakteristika e Paisjes

Penetrometer Dinamik DPT, Tipi Pagani TG 30-20

- Pësia e masës së çekicit: $M = 30 \text{ kg}$
- Lartësia e lirë që bie: $H = 20 \text{ cm}$
- Diametri Konit: $D = 35.7 \text{ mm}$
- Pësia e konit: $Pp = 12 \text{ kg}$
- Sipërfaqja e bazës konike $A = 10.0 \text{ cm}^2$
- Këndi i hapjes së konit $\alpha = 60^\circ$
- Gjatësia e astës: $L = 100 \text{ cm}$
- Pësia e Astës për metër: $P = 2.4 \text{ Kg}$
- Distanca mes leximeve: $\delta = 10 \text{ cm}$

• Shënime të Investigimit:

Përpunimi i të dhënave është i bazuar në korrelacione të njohura empirike duke ofruar një ndërtimin litostratigrafik jo të vecantë, por që del nga interpretimi i operatorit, dhe informacioni i marrë në vend gjatë kryerjes së provës penetrometrike. Për llogaritjen e parametrave gjeoteknik nga kjo metodike studimi janë përdorur tabelat koreluese për argjilat, rërat sipas Skempton 1986. Përpunimi i të dhënave është bërë me softwarin DynamicaDPT (Italy). Në këtë software për llogaritjet e parametrave të ndryshëm gjeoteknik janë përdorur korrelacionet empirike të autorëve si më poshtë:

Kendi ferkimit prerje (°)	Mod. Edom. shkriфт (kg/cm ²)	Kohezion i jo drenuar (kg/cm ²)	Mod. edom. Koheziv (kg/cm ²)	Densite relative (%)	Moduli Young kg/cm ²	Mod.dinamik ne prerje shkriфтa (kg/cm ²)	Mod.dinamik prerjes kohezive (kg/cm ²)	Raporti i konsolidim
Meyerhof ->5% limo	Farrent	Terzaghi & Peck	Stroud Butler 20<IP<40	Skempt o 1986	Stroud	Crespellani e Vannucchi	Crespellani e Vannucchi	Ladd & Foot

Detajet e Investigimit:

Janë kryer 4 prova me penetrometër dinamik në këto thellësi: **DPT1:** 15 m, **DPT2:** 12 m, **DPT3:** 13m , **DPT4:** 15m. Nga llogaritjet e kryera sipas programit kompjuterik të kombinuara me vrojtimet në terren kemi arritur të evidentojmë katër shtresa të cilat janë:

Shtresa e parë: Tokë vegjetale me ngjyrë gri, e karakterizuar nga një strukturë e dendur dhe e ngjeshur. Thellësia në:

DPT1 (0.0 m deri 1.30m)

DPT2 (0.0 m deri 1.20 m)

DPT3 (0.0 m deri 1.20 m)

Tabela 1. Parametrat gjeoteknik për shtresën e parë

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Dendësia relative Dr (%)	79,3	95,7	81,4	85,5
Këndi fërkimit të brendshëm (°)	28,1	30,8	28,4	29,1
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	1,58	1,72	1,59	1,6
Moduli deformimit të drenuar M (kg/cm ²)	81,5	117,7	84,9	94,7
Moduli deformimit i Yungut E (kg/cm ²)	241,8	290,8	246,9	259,8
Moduli deformimit në prerje G₀ (T/ m ²)	6442	9108	6695	7415,0
Shpejtësia e valës sizmike Vs (m/sek)	148,7	158	149,3	152,0
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,4	3,3	2,5	2,7
N_{spt}	11,5	16,6	12	13,4
(qc/pa) / N ₆₀	4,2	4,0	4,2	4,1
Treguesi i sjelljes së dherave I_c	2,3	2,5	2,3	2,4

Shtresa e dytë: Material ranor me përbërje surerash dhe rëre kokërrimet, me strukturë të shkrifët, lagështi të pranishme dhe ngjyrë gri e errët. Thellësia në:

DPT1 (1.30 m deri 8.0m),

DPT2 (1.20 m deri 8.0 m),

DPT3 (1.20 m deri 8.0 m)

Tabela 2. Parametrat gjeoteknik për shtresën e dytë

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Indeksi konsistencës Ic	0,62	0,69	0,71	0,7
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	0,75	0,86	0,91	0,8
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	2	2,04	2,05	2,0
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	55,7	64,5	68,1	62,8
Moduli i prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	9174	10292	10734	10066,7
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,4	2,23	2,37	2,3
Nspt	13,7	12,9	13,6	13,4
(qc/pa) / N ₆₀	3,5	3,5	3,5	3,5
Treguesi i sjelljes së dherave Ic	2,72	2,73	2,71	2,7

Shtresa e tretë: Përzierje surerash dhe suargjile me strukturë të shkrifët dhe përmbajtje lagështie të moderuar. Thellësia në:

DPT1 (8.0 m deri 12 m),

DPT2 (8.0 m deri 11.7 m),

DPT3 (8.0m deri 11 m),

Tabela 3. Parametrat gjeoteknik për shtresën e tretë

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Indeksi konsistencës Ic	0,75	0,78	0,71	0,7
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	0,99	1,07	0,91	1,0
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	2,06	2,08	2,05	2,1
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	74	80	68,6	74,2
Moduli i prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	11456	12171	10790	11472,3
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,0	1,985	1,925	2,0
Nspt	14,8	16	13,7	14,8
(qc/pa) / N ₆₀	2,7	2,5	2,8	2,7
Treguesi i sjelljes së dherave Ic	3,11	3,25	3,08	3,1

Shtresa e katërt: Përzierje surerash dhe suargjile me ngjyrë gri, me strukturë mesatarisht të ngjeshur dhe përmbajtje lagështie. Thellësia në:

DPT1 (12 m deri 15 m)

DPT2 (11.7 m deri 12 m),

DPT3 (11m deri 13 m),

Tabela 4. Parametrat gjeoteknik për shtresën e katërt

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Indeksi konsistencës Ic	0,92	0,97	0,88	0,9
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	1,49	1,79	1,36	1,5
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	2,11	2,13	2,1	2,1
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	111,2	133,3	101,8	115,4
Moduli i prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	15732	18129	14683	16181,3
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,4	3,1	2,3	2,6
N_{spt}	22,2	26,7	20,4	23,1
(qc/pa) / N₆₀	2,2	2,3	2,3	2,3
Treguesi i sjelljes së dherave Ic	3,42	3,35	3,36	3,4

Lidhja ndërmjet vlerave të DPT dhe vetive të rërave (sipas Curtin et. Al.2006)

	Shumë të shkrifta	Të shkrifta	Mes. të ngjeshura	Të ngjeshu ra	Shumë të ngjeshura
Vlera SPT(N goditje 0.3) ^a	< 4	4-10	10-30	30-50	> 50
CPT (qc rezitenca e konit) ^b	< 5	5-10	10-15	15-20	>20
Dendësia relative (%) ^c	< 15	15-35	35-65	65-85	85-100
Pesha vëllimore e skeletit	< 14	14-16	16-18	18-20	>20
Këndi i fërkimit (gradë)	< 30	30-32	32-35	35-38	38

Shënim a) për një ngarkesë vertikale 100kPa, b) nuk është vlera unike mund të ndryshojë nga kushtet lokale nga vendi, c) depozitime të reja, rëra normalisht të konsoliduara.

Vlera-Nspt(Test Penetrimit Standard)

Vlera-N e **SPT** – së derivohet duke përdorur lidhje të ndryshme midis **qc** dhe **N₆₀**. Këto raporte u sugjeruan nga Robertson etj. (1986) dhe tregohen në tabelën më poshtë.

Nisur nga numri i goditjeve N_{spt} (N_{60}), dhe mardhëniet me q_c (rezistenca e matur e konit R_{pd}), dhe p_a (ngarkesa vertikale 100kPa) dalim në përcaktimin e tipit të sjelljes së dherave **Ic** sipas Robertsonit 1986.

Tabela 5. Raportet e vlerës-N e SPT – së nga Robertson etj., 1986.

Zona	Tipi i Sjelljes së Dheut	(q_c/p_a)/ N_{60}
1	Kokërr imët të ndjeshëm	2
2	Material ORGANIK	1
3	Argjilë	1
4	ARGJILE pluhurore në ARGJILE	1.5
5	PLUHUR argjilor në ARGJILE	2
6	PLUHUR ranor në PLUHUR argjilor	2.5
7	RERE pluhurore në PLUHUR ranor	3
8	RERE në RERE pluhurore	4
9	Rërë	5
10	RERE në RERE zhavorrore	6
11	Kokërr imët shumë i ngurtë	1
12	RERE në RERE argjilore	2

Për rezultate më të mira për llogaritjen e **N60** rekomandohet përdorimi i treguesit të tipit të sjelljes së dheut, **Ic**. Marrëdhënia midis **N60** dhe **Ic** përcaktohet si:

Për rezultate më të mira për llogaritjen e **N60** rekomandohet përdorimi i treguesit të tipit të sjelljes së dheut, **Ic**. Marrëdhënia midis **N60** dhe **Ic** përcaktohet si:

$$\frac{q_c/p_a}{N_{60}} = 8.5 (1 - Ic/4.6) \quad (\text{Lunne etj., 1997})$$

Jefferies and Davies (1991), sugjerojnë se kjo metodë siguron një vlerësim më të mirë të vlerës-N të SPT-së, edhe në krahasim me vete testin e SPT-së, për shkak të përsëritshmërisë së dobët që ka ky test.

Nisur nga formula e Robertsonit kemi nxjerrë raportin $\frac{q_c/p_a}{N_{60}}$ për çdo shtresë të vendosura në tabelat e rezultateve. Llogarisim **Ic** sipas formulës (Lunne etj. 1997) që jepet në tabelën për çdo shtresë.

Tabela 6. Përqindja e fraksionit të imët FC sipas kufijve të indeksit të sjelljes së dheut I_c (Robertson 1990)

Indeksi i tipit të dheut I_c	Zona SBT	Klasifikimi USCS	FC (%) Fraksioni i imët
$I_c < 1.31$	7	Rëra zhavorrore deri rëra të trasha	0
$1.31 \leq I_c < 1.59$	6	Rëra të pastra	0 - 5
$1.59 \leq I_c < 1.83$	6	Rëra me pluhur	5 - 12
$1.83 \leq I_c < 2.276$	5/6	Rëra pluhurore	12 - 35
$2.276 \leq I_c < 2.5$	5	Rëra pluhurore, Pluhurore me rëra	35 - 50
$2.5 \leq I_c < 2.68$	5/4	Pluhurore me rëra deri në rëra	50 - 65
$2.68 \leq I_c < 2.95$	4	Pluhurore argjilore deri argjila	65 - 87.4
$2.95 \leq I_c < 3.1$	3	Argjila pluhurore	87.4 - 100
$3.1 \leq I_c < 3.6$	3	Argjila	100
$I_c \geq 3.6$	2	Dhera organike, torfa	100

Nisur nga tabela e sipërme (Robertson 1990), del që përbërja e fraksioneve është:

- **për shtresën e parë:** $I_c = 2.4$, Indexi i tipit të dheut $2.276 \leq I_c < 2.5$, zona SBT - 5, Klasifikimi USCS “Rëra pluhurore, Pluhurore me rëra SM” dhe Fraksioni i imët FC = 35%. Pra kemi “Rëra pluhurore” ku 65% janë rëra që kalojnë në sitën No.10 (2.0 mm) to No. 40 (0.425 mm) dhe 35% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

- **për shtresën e dytë:** $I_c = 2.7$, Indexi tipit të dheut $2.68 \leq I_c < 2.95$, zona SBT - 4, Klasifikimi USCS “Pluhurore argjilore deri argjila –Sc”, dhe Fraksioni i imët FC = 40%.

Pra kemi: Rëra pluhurore ku 60% janë rëra që kalojnë në sitën No.10 (2.0 mm) to No. 40 (0.425 mm) dhe 40% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

- **për shtresën e tretë:** $I_c = 3.1$, Indexi tipit të dheut $2.95 \leq I_c < 3.1$, zona SBT - 3, Klasifikimi USCS “Argjila pluhurore - CM”, dhe Fraksioni i imët FC = 80%.

Pra kemi: Rëra pluhurore ku 20% janë rëra që kalojnë në sitën No.10 (2.0 mm) to No. 40 (0.425 mm) dhe 80% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

- **për shtresën e katërt:** $I_c = 3.4$, Indexi tipit të dheut $3.1 \leq I_c < 3.6$, zona SBT - 3, Klasifikimi USCS “Argjila pluhurore – CM”, dhe Fraksioni i imët FC = 85%.

Pra kemi: Pluhur argjilor ku 15% janë rëra që kalojnë në sitën No.10 (2.0 mm) to No. 40 (0.425 mm) dhe 85% janë pluhura që kalojnë në sitën Nr. 200 (0.075mm).

Rezultatet e analizave fiziko – mekanike te mostrave te Pusit te studimit ne afersi te godines se parkimit.

Nr. Sond	Thellesi mostres shpimi	Kufi sipem plastic	Kufi poshtm plastic	Indeksi plasticitet	Lageshti natyror	Masa Volum.	Masa specifik	Granulometri (%)		
	(m)	(LL)	(PL)	(PI)	(%)	Kg/cm ³	Kg/cm ³	<0.06 3	0.063 - 0.125	>0.12 5-
S3	8.3-8.7	Jo plastik			22.61	2146	2.705	35.24	26.8	37.96

Litologjia e Shtreses se 2 – te, bazuar ne pusin e shpuar

Ne baze te karakteristikave fiziko - mekanike, perberjes litologjike dhe kushteve te formimit ne sheshin e ndertimit kjo shtrese perbehet nga:

Surera e rera kokerrimeta, te shkrifeta me lageshtire, ngjyre gri te erret, keto depozitime jane shkriferime plazhi.

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:
Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.063 mm	35.24	%
Fraksioni pluhuror	0.063-0.125 mm	26.80	%
Fraksioni rere	> 0.125 mm	37.96	%
Lageshtia natyrore	$w_n = 22.61$		%
Pesha specifike	$\Delta = 2.705$		gr/cm ³
Pesha volumore ne gjendje natyrale	$\gamma = 2.146$		gr/cm ³
Moduli i kompresionit	$E = 0.1$		kg/cm ²
Kendi i ferkimit te brendshem	$\phi = 25$		°
Kohezioni	$c = 0.01$		kg/cm ²
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	$\sigma = 1.80$		kg/cm ²

10. Faktorët që ndikojnë në lëngëzimin e dherave

Lëngëzimi i dherave varet nga disa faktorë që të zhvillohet si dukuri. Bazuar në vëzhgimin në terren dhe rezultatet e testimeve laboratorike nga autorë të ndryshëm, karakteristikat e lëngëzimit të dherave ndikohen nga një numër i madh faktorësh (GDP-9, 2015):

- Përbërja granulometrike dhe lloji dheut;
- Dendësia relative;
- Karakteristikat e goditjes së tërmetit;
- Sforcimi vertikal efektiv;

- Mosha e dherave dhe historia e zhvillimit gjeologjik të mjedisit;
- Niveli i ujrave nëntokësorë, shkalla e lagështisë në dhera dhe koeficienti i filtrimit;
- Trashësia e shtresës së dheut që lëngëzohet dhe thellësia nga sipërfaqja e tokës.

10.1 Pritshmerite per lëngëzim

Pritshmëria e dherave për lëngëzim varet nga lloji i dheut ku në varësi të përbërjes granulometrike të rërave pas shumë analizave granulometrike të kryera për dherat të cilat janë lëngëzuar ose jo gjatë tërmeteëve. Tsuchida (1972) ka propozuar kufijtë për ndarjen e dherave në të lëngëzueshëm dhe të palëngëzueshëm në kurbën granulometrike (Figura 3.15).

Sipas kufijve të propozuar (Tsuchida 1970), dherat që bien në zonën e parë midis dy kurbave të brendshme përfaqsojnë dherat që kanë pritshmëri të lartë lëngëzimi, ndërsa dherat që bien në zonën e dytë midis kurbave të jashtme mund të kenë pritshmëri për lëngëzim dhe dherat që bien jashtë këtyre zonave nuk paraqesin pritshmëri lëngëzimi.




Fig. Kurba granulometrike për dhera që lëngëzohen (Tsuchida 1970).

Për dherat pa kohezion referuar përbërjes granulometrike (Figura sipër) sipas sistemit të klasifikimit USCS i përkasin grupeve, SC-SM.




Fig. Kurba granulometrike e pusit referuar

Sipas paraqitjes grafike te shperndarjes se madhësisë se grimcave ne pusin qe i jemi referuar, shofim qe kurba granulometrike bie brenda zones “Dhera shume te lengezueshem“, sipas (Tsuchida 1970).

Fillimisht për shumë kohë është menduar se lëngëzimi ndodh vetëm në rërat shkriфта pasi për dherat e tjera është konsideruar si e pamundur rritja e presionit të ujit të poreve, që lidhet me tendencën për lëngëzim, por sipas grafikut të propozuar nga Tsuchida dherat që bien në zonën e dytë i përkasin llojit të dherave me përmajtje të fraksionit të imët. Në vijim autorë të ndryshëm kanë studiuar mundësinë e lëngëzimit për dherat kokërrimët. Nga Wang (1979) janë propozuar kriteret që duhet të plotësojnë dherat që të ketë pritshmëri për lëngëzim: Përmajtje të fraksionit të imët (FC) 0.05mm të jetë në kufijtë 15% - 20%, lagështia natyrore në vlerat 0.9 W LL.

11. Gërmimet e themelit dhe masat inxhinerike për stabilizimin e skarpateve

Figura: 5. Mesatarja mujore e lageshtise se ajrit ne %

2.6 Era

Era percaktohet si levizje horizontale e ajrit, ndersa levizja vertikale quhet rryme ajri. Karakteristikat kryesore te eres jane drejtimi dhe shpejtesia.

Shpejtesia e eres matet me anemometer ne lartesi te ndryshme dhe mund te shprehet ne m/s , m/ore , km/s etj.

Shpejtesia e eres matet me ane te instrumentave qe quhen anemometra .Per shkak te ferkimit me siperfaqen e tokes mbi te cilen fryn era shpejtesia e saj peson nje zvogelim ne lidhje me lartesine.

Duke u bazuar ne matje te shpejteise se eres ne lartesi te ndryshme eshte percaktuar nje lidhje empirike qe jep lidhjen ndermjet shpejtesise se eres dhe lartesis:

$$(u/u_0) = (z/z_0)^{0.15}$$

- $u(0)$ eshte shpejtesia e eres ne anemometer ne lartesine z_0
- u eshte shpejtesia e eres ne lartesine z

Nisur nga te dhenat e Insitutit Hidrometerologjik konkretisht ne Literaturen (Klima e Shqiperise Era tab.3) marrim keto te dhena sa i perket rastisjeve shumevjeqare te shpejtesise se eres sipas ketyre drejtimeve:

Drejtimi i eres	Shpejtesia Mesatare e Eres m/s	Rastesia
V	3.3	3.1
VL	2.9	5.9
L	2.9	15.9
JL	3.7	3.4
J	5.8	7.2
JP	5.4	5.2
P	3.8	6.6
VP	4.7	10.2

Tabela 2-4 Rastisja shumevjeqare e shpejtesise se eres sipas drejtimeve ne Vlore




Figura 6 :Trandafili i Ererave.Vendmatja Vlore

Nga trandafili i ererave vihat re se ne Vlore mbizoterojne ererat e sektorit Lindor dhe Verior konkretisht ererat e drejtimimit L dhe VP.

Ndertim I godines se parkimit nenetokesor dhe I parkut shplodhes Vlore

Muaji	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
1	4.0	3.4	3.5	4.4	7.1	5.7	2.7	3.4
2	3.6	3.1	3.3	5.3	6.7	6.0	4.0	4.5
3	3.6	3.5	3.2	5.3	6.4	6.0	4.2	4.7
4	3.5	2.8	2.9	5.5	6.9	6.2	4.1	5.4
5	5.6	2.6	2.6	2.2	5.4	5.2	4.2	5.1
6	3.0	3.0	2.7	1.9	5.4	5.1	4.1	5.6
7	3.2	2.4	2.3	1.0	4.4	5.0	4.2	6
8	3.7	2.4	2.4	1.0	4.1	4.8	4.3	5.8
9	3.1	2.6	2.7	1.9	4.7	5.0	4.0	5.1
10	2.8	3.0	2.2	4.7	4.7	4.7	3.2	4.1
11	3.0	2.9	3.1	5.2	6.8	5.3	3.7	5.6
12	3.0	3.1	3.3	5.6	7	5.7	3.4	3.2

Tabela 2-5 Shpejtesite mesatare brendavjetore ne m/s

1.7 Reshjet atmosferike

2.7.1 Reshjet ne Forme shiu

Burimi reshjeve te shiut eshte gjithmone deti. Avullimi behet nga oqeanet dhe avujt e ujit thithen nga rrymat e ajrit qe levizin mbi siperfaqen e detit. Ajri I ngarkuar me lageshti mban avujt e ujit te thithur deri ne piken e veses. Kur keta avuj ndeshen ne temperatura me te ulta kemi reshjet e shiut.

E kur keto temperature jane mjaftueshmerisht te ulta reshjet jane ne formen e bores.

Reshjet kryesisht jane ne formen e shiut,por kemi edhe ne forme bresheri, bore me shi dhe vetem bore.Ne Shqiperi te dhenat e reshjeve regjistrohen dhe ruhen nga Instituti Meteorologjik i Ujit, Energjise dhe Mjedisit

Reshjet jane parameter i permbytjeve dhe ne Shqiperi, ne menyre te vecante reshjet e shiut, pasi ato te bores nuk kan ndonje ndikim ne fenomenin e permbytjeve, por ndikojne ne prurjet e lumejve ne zona te caktuara.

Ne pellgje te medha sasia, intensiteti dhe shperndarja e reshjeve eshte faktor i rendesishem dhe determinues ne fenomenine permbytjeve por intensiteti i tyre eshte faktor determinues.

Relievi I ndryshueshem dhe distance nga deti ndikojne ne sasine e reshjeve ne nje zone.

Për shkak te veprimtarise se gjere ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihen re ne gjysmen e ftohte te vitit, dhe ajo më e ulet ne periudhen e ngrohtë te tij. Zona ne studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi rreshjesh vjetore mesatarisht 938 mm ne vit të cilat bien ne formë shiu. Muaji me më shume rreshje është muaji dhjetor (153 mm), i ndjekur nga muaji nentor (130 mm). Muaji me më pak

Ndertim I godines se parkimit nenetokesor dhe I parkut shplodhes Vlore

rreshje është muaji korrik me 17 mm. Numri i ditëve me rreshje ≥ 1.0 mm varion nga 5 ditë (korrik) deri në 14 ditë (dhjetor).

Gjatë vitit ka mesatarisht 116 ditë me reshje ≥ 1.0 mm. Zona ne studim nuk klasifikohet si zone me sasi te medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo ben pjese ne zonat ku shirat jane me pak te rrembyeshem. Rreshjet jane nje element i rendesishem meteorologjik, qe ne rajonin e Vlorës kryesisht perfaqesohen nga shiu.

Ne tabelen e meposhteme jepen sasite mesatare per çdo muaj te rreshjeve qe bien ne kete zone. Keto vlera jane rezultat i perpunimit te serive shumevjeçare te reshjeve (30,40 vjet), seri vrojtimesh e pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise per kryerjen e studimeve klimatike te nje rajoni te dhene

Muaji	Jan	Shk	Mars	Prill	Maj	Qers.	Kor.	Gu.	Shtat.	Tet.	Nënt	Dhj.
Rreshjet Mesatare (mm)	106.0	112.0	108.0	88.0	53.0	24.0	17.0	15.0	46.0	86.0	130.0	153.0
Dite Me Rreshje	11.0	12.0	12.0	12.0	10.0	6.0	5.0	5.0	8.0	9.0	12.0	14.0
50-100 mm	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
20-50 mm	1.0	2.0	0.0	1.0	1.0	0.0	0.0	0.0	1.0	1.0	2.0	2.0
10-20 mm	2.0	2.0	2.0	2.0	1.0	1.0	0.0	0.0	1.0	2.0	2.0	3.0
5-10 mm	2.0	3.0	3.0	3.0	2.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	2.0	3.0
2-5 mm	3.0	2.0	3.0	3.0	2.0	1.0	1.0	1.0	2.0	2.0	3.0	3.0
< 2 mm	3.0	3.0	4.0	3.0	4.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
Ditë e Thatë	20.0	16.0	19.0	18.0	21.0	24.0	26.0	26.0	22.0	22.0	18.0	17.0

Tabela 2-6 Te dhenat e rreshjeve Stacioni Vlorë




Figura 7 Histograma e sasisë mesatare mujore të rreshjeve. Stacioni Vlore

Ndertim I godines se parkimit nenetokesor dhe I parkut shplodhes Vlore




Figura 8 Rreshjet ne Vlorë, Vjetore (majtas), vere (djathtas) dhe dimer (në mes)

2.7.2 Regjimi Hidrologjik

Një tregues i rëndësishëm dhe i dobishëm për qëllime hidroteknike dhe urbanistike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale për intervale të tjera kohor për periudha të ndryshme përsëritje.

Duke u mbështetur në seritë e vlerave maksimale të reshjeve të rena gjatë 24 orëve janë llogaritur vlerat e pritura të intensiteteve të reshjeve për periudha të ndryshme përsëritje.

Në tabelat e mëposhtme shfaqen dhe prurja mesatare ndër vite të matura dhe të përpunuara për përqindje sigurie të ndryshme.

VEND	MMND	24h	Cv	Cs	1	2	5	10	25	50	75	90	99	VITE
Vlorë	3	70.2	0.39	2.34	166.0	140.0	120.0	102.0	81.4	64.6	52.6	44.2	33.8	23

Tabela 2-7 Rreshjet me të mëdha 24h për sigurinë P%, Vendmatja Vlorë³

Për stacionin e Vlorës, brenda 24 orëve pritet të bien 166 mm shi për sigurinë 1% dhe për sigurinë 10% (periudha e përsëritjes 1 herë në 10 vjet) pritet të bien 102 mm.

Rregjimi hidrologjik është një faktor i rëndësishëm në projektimin e rrjedhës sipërfaqësore dhe kanalizimeve pasi lidhet ngushtë me llogaritjen e infiltrimeve.

Rregjimi hidrologjik është i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërdrejt në permasimin e kolektoreve dhe rrjedhimisht edhe në koston e investimit.

³ Marre nga manuali i Shirave Maksimale me Siguri të Ndryshme në zonën e Vlorës, Instituti Hidrometeorologjik

Kohëzgjatja e reshjeve [orë]	Siguria (shpeshtësia) [%]					
	1	2	5	10	20	50
	I [mm]	I [mm]	I [mm]	I [mm]	I [mm]	I [mm]
24	202	183	158	136	107	84
12	188	169	141	121	100	70
6	175	154	130	109	88	58
2	112	100	83	70	57	38
1	86	77	64	56	45	31
0.5	58	52	44	38	31	21
0.33	50	45	37	31	26	18
0.1667	33	37	31	20	17	12

Tabela 2-8 Intesitetet Orare me periudhë përsëritje të ndryshme, Stacioni Vlorës⁴




Figura 9 Grafiku Kurba IDF Qyteti Vlores sipas Tabeles

2.7.3 Reshjet ne forme Bresheri

Ditet me bresher te regjistruara ne satcionin e Vlores paraqiten ne tabelen me poshte.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VII	IX	X	XI	XII	Viti
Vlora	1,3	1,23	0,8	0,5	0,3	0,1	-	0,1	0,1	0,2	0,06	1.0	6,2

Tabela 2-9 Ditët me breshër gjatë vitit

2.7.4 Reshjet ne forme debore

Per shkak te ndikimit te detit, ne ultesiren perendimore nuk ka kushte per krijimine shtresave te bores. Reshje bore edhe mund te kete por kushtet jane te atilla qe ajo shkrine shpejt(nuk mban).Periudhe me e mundeshme per reshje bore eshte periudha Janar - Shkurt. Shtresa e bores e vrejtur ne Vlore ka qene 9cm.

2. Hidroteknika

⁴ Marrë nga “Rregulli teknik për ndërtimin e Rrugëve (RrTNRr-4) – Kullimi, Shtojca A - Kurbat IDF”

2.1 Te pergjithshme

Sikurse eshte percaktuar ne Detyrat e Projektimit konkretisht Pika – “Të dhenat për projektim”

- Perspektiva e rrjetit KUB dhe KUZ të parashikohet për 50vjet. Mbrojtja e investimit
- Materiali i tubacionit të rrjetit shimbledhe të jetë CHDPE sipas standartit EN12666 dhe EN12201
- Materiali i tubacionit të rrjetit kanalizimeve të jetë CHDPE sipas standartit EN12666 dhe EN12201.

2.2 Llogaritja e sasisë së rrjedhes ne pellgun shimbledhes

Per te vleresuar prurjen e gjeneruar nga rreshjet atmosferike do te shfrytezojme nje metode llogaritese mjaft praktike e quajtur **Metoda Racionale**. Metoda Racionale llogarit, në çfarëdo lloj vendndodhjeje të një baseni ujëmbledhës, vlerën maksimale të prurjes, koeficientin dhe intensitetin mesatar të rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqëndrimit (koha që i duhet ujit për të rrjedhur nga pika më e largët e basenit në vendndodhjen që po analizojmë), si funksion të zonës së kullimit.

Sipas kesaj metode vlera e prurjeve, te gjeneruara pas nje fenomeni atmosferik jepet :

Formula racionale është e shprehur si më poshtë:

$$Q = \frac{C \cdot C_f \cdot I \cdot A}{k}$$

Ku:

- Q = vlera maksimale e prurjes, m³/s;
- C = koeficienti i rrjedhjes që përfaqëson një raport të rrjedhjes e të rreshjeve të shiut;
- C_f = Faktori i frekuences (Rajti-Meklaflini, 1969).
- I = intensiteti mesatar i rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqëndrimit, për një periudhë të përzgjedhur kthimi, mm/h;
- A = sipërfaqja e kullimit që kontribuon në vendndodhjen e projektuar, ha.
- k = Koeficienti i konvertimit te njesive. k=360 per sistemin SI (metrik)

LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C	LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C	LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C
BIZNES		INDUSTRIALE		LËNDINA	
Zona në qendër	0.70 - 0.95	Zona të lehta	0.50 - 0.80	Tokë ranore, e sheshtë, 2%	0.05 - 0.10
Zona fqinje	0.50 - 0.70	Zona të rënda	0.60 - 0.90	Tokë ranore, mes, 2 - 7%	0.10 - 0.15
REZIDENCIALE		Parqe, varreza	0.10 - 0.25	Tokë ranore, rrëpirtë, 7%	0.15 - 0.20
Zona me familje teke	0.30 - 0.50	Parqe lojrash	0.20 - 0.40	Tokë e rëndë, e sheshtë, 2%	0.13 - 0.17
Multi-njësi, të veçuara	0.40 - 0.60	Zona hekurudhore	0.20 - 0.40	Tokë e rëndë, mesatare 2 - 7%	0.18 - 0.22
Multi-njësi, të ngjitura	0.60 - 0.75	Zona të parregulluara	0.10 - 0.30	Tokë e rëndë, e rrëpirtë, 7%	0.25 - 0.35
Periferike	0.25 - 0.40	RRUGË			

Ndertim I godines se parkimit nenetokesor dhe I parkut shplodhes Vlore

LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C	LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C	LLOJI I ZONËS SË KULLIMIT	KOEFICIENTI I RRJDHJES, C
Zona me apartamente banimi	0.50 - 0.70	Të asfaltuara	0.70 - 0.95	Tulle	0.70 - 0.85
		Beton	0.80 - 0.95	Rrugë mak. dhe këmbës.	0.75 - 0.85
				Shtresë e sipërme	0.75 - 0.95
Vlerat më të larta zakonisht janë të përshtatshme për zona më të rrëpirta dhe të pjerrëta dhe me periudha kthimi më të gjata, sepse filtrimi dhe të tjera humbje kanë një efekt proporcionalisht më të vogël mbi rrjedhjen në këto raste.					

Tabela: 3-1 Koeficientët e Rrjedhjes

Intervali i Përsëritjes (vjet)	<25	25	50	100
Cf - Faktori i frekuences	1.0	1.1	1.2	1.25

Tabela 3-2 Faktori I Frekuencës

Nga literatura teknike nje veper hidraulike ka nje jetegjatesi qe varion nga 30-40vjet (kanalizimet e ujërave të shiut) dhe 100 vjet (digat), zakonisht kanalizimet e ujerave te shiut (me rrezik te ulet) dimensionohen me nje periudhe perseritje 10-20 vjet, argjinaturat 100-1000 vjet, pilat e urave 100-500 vjet dhe veprat e shkarkimit te ujerave te teperta ne diga 1000-10000 vjet.

$$I = \frac{P \cdot 60}{T_c}$$

Ku:

- I eshte intensiteti I shiut ne mm / ore,
- T_c –kohezgjatja ne min
- P – Thellesia e rreshjeve per kohezgjatjen T_c dhe sigurine e paracaktuar.

Koha e Përqendrimit' per cdo kapje mund te llogaritet nga nje numer formulash .

Kur vleresojme prurjen e gjeneruar nga rreshjet atmosferike permes Metodes Racionale, koha qe i nevojitet ujit per te rrjedhur nga pika me e larget e pellgut shimbledhes deri ne hyrjen e pare ne rrjet e kanalizimit, quhet **Inlet Time**.

Intensiteti i Reshjeve të shiut (I): intensiteti i reshjeve të shiut është ai intensitet i shprehur në mm për orë për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqendrimit. Intensiteti është norma e reshjeve të shiut gjatë një intervali kohe e njëvlershme me intensitetin e shumëzuar me kohëzgjatjet e barabarta të sasive të reshjeve të rëna,

Koha e përqendrimit të reshjeve (T_c) përkufizohet si periudha që i nevojitet ujit të zhvendoset nga pika më e lartë hidraulike e basenit ujëmbledhës në pikën e sistemit të kullimit të ujrave të shiut që kemi në shqyrtim. Projektuesi zakonisht është i interesuar për dy kohë të ndryshme të përqendrimit: e para për madhësinë e hyrjes dhe tjetra për dimensionimin e tubave. **Midis këtyre dy kohëve ka një ndryshim të madh.**

Koha e përqëndrimit (Tc Inlet Time) për hapësirën e hyrjes është koha që i duhet ujit të zhvendoset nga pika më e lartë hidraulike e sipërfaqes drenuese për në hyrje, që njihet ndryshe si koha e hyrjes. Zakonisht kjo është shuma e kohës që i nevojitet ujit të lëvizë përgjatë sipërfaqes së tokës. Koha e përqëndrimit për dimensionimin e tubave është e përcaktuar si koha e nevojshme që i duhet ujit të zhvendoset nga pika më e largët e basenit ujëmbledhës në pikën e sistemit të kullimit të ujrave të shiut që kemi në shqyrtim. Zakonisht konsiston në dy komponente (i) koha që duhet ujit që të zhvendoset në hyrjen që mund të përbëhet nga grykëderdhja dhe kanali ose ulluku dhe (ii) koha që i duhet ujit që të zhvendoset nëpër drenazhin e ujrave të shiut për në pikën që kemi në shqyrtim.

Në mënyrë të përmblodhur, koha e përqëndrimit për çdo pikë në një drenazhues të ujrave të shiut është shumatorja e kohës së hyrjes për hyrjen në pikën që ndodhet në fundin e sipërm të linjës dhe kohës së prurjes që kalon nëpër drenazhuesin e ujrave të shiut nga pika fundore e sipërme e drenazhuesit për në pikën që kemi në shqyrtim. Në përgjithësi, atje ku ka më shumë se një burim rrjedhjeje në një pikë të dhënë në sistemin e kullimit, koha e përqëndrimit t_c më e gjatë përdoret për të vlerësuar intensitetin (i). Mund të ketë përjashtime, për shembull, atje ku kemi një sipërfaqe të madhe ujëmbledhëse në një pikë përgjatë sistemit, koha e përqëndrimit t_c për atë sipërfaqe mund të prodhojë një shkarkim më të madh sesa koha e përqëndrimit t_c për shumatoren e sipërfaqeve me kohë përqëndrimi më të gjatë t_c . Projektuesi duhet të jetë në dijeni të kësaj mundësie në momentin e bashkimit të sipërfaqeve të kullimit dhe të përcaktojë se cila sipërfaqe ka rolin drejtues. Që të përcaktohet se cila sipërfaqe ka kontrollin kryesor, llogaritet shkarkimi maksimal për çdo kohë përqëndrimi t_c . Vëmë re se kur llogarisim shkarkimin maksimal me kohën minimale t_c , atëherë jo e gjithë sipërfaqja që fillon nga baseni me kohën më të lartë të përqëndrimit t_c .

2.3 Analiza e shirave maksimale relizohet edhe me metoden statistikore. Me e perhapura qe ka gjetur zbatim shperndarja e probabiliteteve Gumbel.

Per kete qellim jane llogaritur intensitetet e shirave duke perdorur te dhenat e rregjistruara ne stacionin e Vlores. Bazuar mbi keto te dhena u analizuan serite e te dhenave te shirave me kohezgjatje 10, 20,30,60,120,180 dhe 360 minuta.

Llogaritja e shirave qe nevojiten per projektimin e strukturave hidraulike u kryen me ane te metodes statistikore.

Probabiliteti i ndodhjes se shirave maksimale me nje shtrese dhe kohezgjatje te caktuar u llogarit me ane te shperndarjes se probabiliteteve Gumbel:

$$X_p = a + 1/\alpha * Y_p$$

Ku Y_p ndryshore e reduktuar.

$$Y_p = -\ln\{-\ln(1-p)\}$$

$$1/\alpha = \bar{O}_x / 1.28 \text{ dhe } a = X_m - 0.45 \bar{O}_x$$

Ku X_m dhe $\bar{O}_x$ jane respekttivisht mesatarja dhe shmangia mesatare katrore

Duke ndjekur proceduren e pershkruar me lart u llogariten shtresat e shiut me periodha te ndryshme

per stacionin meteorologjik te Vlores per te cilin ka te dhena mbi shirat e shkurter 10min, 20 min, 30 min etj.

2.4 Kapaciteti percjelles i kunetes.

Llogaritjet e rrjedhjes në kunetë janë të nevojshme për të përcaktuar përhapjen e ujit në bankinë, korsinë e parkimit ose seksionin e shtresës. Një modifikim i **ekuacionit të Manning** mund të përdoret për të llogaritur rrjedhjen. Modifikimi është i nevojshëm sepse rrezja hidraulike në ekuacion nuk përshkruan në mënyrë të përshtatshme seksionin tërthor të kunetës. Për të llogaritur rrjedhjen në kunetë ekuacioni Manning integrohet për një rritje të gjerësisë përmes seksionit.

Ekuacioni rezultat është:

$$Q = \frac{Kc}{n} Sx^{1.67} \cdot S_L^{0.5} \cdot T^{2.67}$$

Ku:

- Kc = 0.376
- n = Koeficient Manning -Betoni 0.013
- Q = Prurja, m3/sek
- T = Gjerësia e rrjedhjes (shtrirja), m
- Sx = pjerrësia tërthore, m/m
- SL = pjerrësia gjatësore, m/m

Sikurse është përcaktuar në Detyrat e Projektimit konkretisht Pika – “Të dhënat për projektim”

- Perspektiva e rrjetit KUB të parashikohet për 50vjet (deri në vitin 2071).
- Perspektiva e kanalizimeve në zonën e KUB të parashikohet për 50vjet (deri në vitin 2071).
- Kolektoret kryesor të shkarkimit të tyre prej tipit box dhe tombino b/a
- Materiali i tubacionit të rrjetit shimbledhe të jetë CHDPE sipas standartit EN12666 dhe EN12201
- Materiali i tubacionit të rrjetit kanalizimeve të jetë CHDPE sipas standartit EN12666 dhe EN12201.

2.5 Llogaritja e sasisë së plotës

Për të vlerësuar prurjen e gjeneruar nga rreshjet atmosferike do të shfrytëzojmë një metodë llogaritëse mjaft praktike e quajtur **Metoda Racionale**. Metoda Racionale llogarit, në çfarëdo lloji vendndodhjeje të një baseni ujëmbledhës, vlerën maksimale të prurjes, koeficientin dhe intensitetin mesatar të rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqendrimit (koha që i duhet ujit për të rrjedhur nga pika më e largët e basenit në vendndodhjen që po analizojmë), si funksion të zonës së kullimit.

Sipas kësaj metode vlera e prurjeve, të gjeneruara pas një fenomeni atmosferik jepet :

Formula racionale është e shprehur si më poshtë:

$$Q = \frac{C \cdot C_f \cdot I \cdot A}{k}$$

Ku:

- Q = vlera maksimale e prurjes, m3/s;
- C = koeficienti i rrjedhjes që përfaqëson një raport të rrjedhjes e të rreshjeve të shiut;

Ndertim I godines se parkimit nenetokesor dhe I parkut shplodhes Vlore

- Cf = Faktori i frekuences (Rajti-Meklaflini, 1969).
- I = intensiteti mesatar i rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqendrimit, për një periudhë të përzgjedhur kthimi, mm/h;
- A = sipërfaqja e kullimit që kontribuon në vendndodhjen e projektuar, ha.
- k = Koeficienti i konvertimit të njësive. k=360 për sistemin SI (metrik)

Intensitetet e reshjeve brenda metodës racionale (**Rational Method**) meren direkt nga kurba IDF të pasqyruara me lart.

Nga literatura teknike një veper hidraulike ka një jetegjatesi që varion nga 30-40 vjet (kanalizimet e ujërave të shiut) dhe 100 vjet (digat), zakonisht kanalizimet e ujërave të shiut (me rrezik të ulet) dimensionohen me një periudhë perseritje 10-20 vjet, argjinaturat 100-1000 vjet, pilot e urave 100-500 vjet dhe veprat e shkarkimit të ujërave të teperta në diga 1000-10000 vjet.

$$I = \frac{P \cdot 60}{T_c}$$

Ku:

- I është intensiteti I shiut në mm / orë,
- T_c –kohëzgjatja në min
- P – Thellesia e reshjeve për kohëzgjatjen T_c dhe sigurinë e paracaktuar.

Koha e Përqendrimit' për çdo kapje mund të llogaritet nga një numer formulash .

Kur vlerësojmë prurjen e gjeneruar nga reshjet atmosferike përmes Metodës Racionale, koha që i nevojitet ujit për të rrjedhur nga hyrja e parë në sistemin e kanalizimeve deri në pikën e cila merret në konsideratë për llogaritje, duke i shtuar *Inlet Time*, jep kohën e përqendrimit (koha e bashkeardhjes).

Inlet time varion :

- 5 – 10min për zonë me densitet të lartë ndertimi dhe me rrugë të ngushta kur rruga që përshkon rrjedhë deri në hyrjen në sistem është mjaft e shkurtër
- 10 - 20 min për zonë të zhvilluar me një terren relativisht jo shumë të pjerrët
- 20 – 30 min për zonë rezidenciale me rrugë të gjera

Sipas autoreve "Metcalf & Eddy", nëse nuk kemi informacion të disponueshëm për zonë të caktuara pranojmë *Inlet Time*=20 min.

Intensiteti i Reshjeve të shiut (I): intensiteti i reshjeve të shiut është ai intensiteti i shprehur në mm për orë për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqendrimit. Intensiteti është norma e reshjeve të shiut gjatë një intervali kohe e njëvlershme me intensitetin e shumëzuar me kohëzgjatjet e barabarta të sasive të reshjeve të rëna,

Koha e përqendrimit të reshjeve (T_c) përkufizohet si periudha që i nevojitet ujit të zhvendoset nga pika më e lartë hidraulike e basenit ujëmbledhës në pikën e sistemit të kullimit të ujërave të shiut që kemi

në shqyrtim. Projektuesi zakonisht është i interesuar për dy kohë të ndryshme të përqëndrimit: e para për madhësinë e hyrjes dhe tjetra për dimensionimin e tubave. **Midis këtyre dy kohëve ka një ndryshim të madh.**

Koha e përqëndrimit (Tc) për hapësirën e hyrjes është koha që i duhet ujit të zhvendoset nga pika më e lartë hidraulike e sipërfaqes drenuese për në hyrje, që njihet ndryshe si koha e hyrjes. Zakonisht kjo është shuma e kohës që i nevojitet ujit të lëvizë përgjatë sipërfaqes së tokës. Koha e përqëndrimit për dimensionimin e tubave është e përcaktuar si koha e nevojshme që i duhet ujit të zhvendoset nga pika më e largët e basenit ujëmbledhës në pikën e sistemit të kullimit të ujrave të shiut që kemi në shqyrtim. Zakonisht konsiston në dy komponente (i) koha që duhet ujit që të zhvendoset në hyrjen që mund të përbëhet nga grykëderdhja dhe kanali ose ulluku dhe (ii) koha që i duhet ujit që të zhvendoset nëpër drenazhin e ujrave të shiut për në pikën që kemi në shqyrtim.

Në mënyrë të përmbledhur, koha e përqëndrimit për çdo pikë në një drenazhues të ujrave të shiut është shumatorja e kohës së hyrjes për hyrjen në pikën që ndodhet në fundin e sipërm të linjës dhe kohës së prurjes që kalon nëpër drenazhuesin e ujrave të shiut nga pika fundore e sipërme e drenazhuesit për në pikën që kemi në shqyrtim. Në përgjithësi, atje ku ka më shumë se një burim rrjedhjeje në një pikë të dhënë në sistemin e kullimit, koha e përqëndrimit tc më e gjatë përdoret për të vlerësuar intensitetin (i). Mund të ketë përjashtime, për shembull, atje ku kemi një sipërfaqe të madhe ujëmbledhëse në një pikë përgjatë sistemit, koha e përqëndrimit tc për atë sipërfaqe mund të prodhojë një shkarkim më të madh sesa koha e përqëndrimit tc për shumatoren e sipërfaqeve me kohë përqëndrimi më të gjatë tc. Projektuesi duhet të jetë në dijeni të kësaj mundësie në momentin e bashkimit të sipërfaqeve të kullimit dhe të përcaktojë se cila sipërfaqe ka rolin drejtues. Që të përcaktohet se cila sipërfaqe ka kontrollin kryesor, llogaritet shkarkimi maksimal për çdo kohë përqëndrimi tc. Vëmë re se kur llogarisim shkarkimin maksimal me kohën minimale tc, atëherë jo e gjithë sipërfaqja që fillon nga baseni me kohën më të lartë të përqëndrimit tc

Koeficienti i rrjedhjes C është variabli i metodës racionale më pak e prekshme nga përcaktimi preciz dhe kërkon gjykim dhe arsyetim nga ana e projektuesit. Ndërkohë që gjykimi inxhinierik do të jetë gjithmonë i nevojshëm për të përzgjedhur koeficientët e rrjedhjes, një koeficient tipik që përfaqëson efektet e njehësuar të shumë parametrave të basenit të kullimit, ajo çka do të diskutohet në vazhdim merr parasysh vetëm efektet e grupeve të tokave, përdorimin e tokës dhe pjerrësinë mesatare të tokës.


Elementi përfundimtar i faktorizuar në përcaktimin e koeficientit të rrjedhjes është pjerrësia e tokës. Me rritjen e pjerrësisë së basenit të kullimit, duhet të rritet edhe vlera e përzgjedhur C. Kjo shkaktohet nga fakti që, ndërsa pjerrësia e zonës së kullimit rritet, shpejtësia e rrymës mbi tokë dhe në kanal rritet gjithashtu, duke krijuar më pak mundësi për ujin të depërtojë në sipërfaqen e tokës. Rrjedhimisht, më shumë rreshje shiu do të rrjedhin në zonën e kullimit.

Me ane te ekuacionit Manning: $Q=V \cdot A$ $V=\frac{k}{n} \cdot \left(\frac{A}{P}\right)^{2/3} \cdot S^{1/2}$

Hartoi Inxh.Hidroteknik

Skënder Çika

SIZMIKA



RAPORT SIZMIK

PËR

“NDËRTIMIN E GODINËS SË PARKIMIT ME 2 KATE

NËNTOKË DHE I PARKUT SHPLODHËS”

BASHKIA VLORË



GJEOKONSULT&CO “ Sh.p.k

PËRMBAJTJA

Hyrje

- ✓ Përcaktimi i kategorisë së truallit
- ✓ Vlerësimin probabilitar të rezikut sizmik të sheshit të ndërtimit.
- ✓ Permbledhje dhe rekomandime
- ✓ Bibliografia

HYRJE

Në këtë raport paraqitet studimi i rrezikut sizmik për “ndërtimin e godinës së parkimit me 2 kate nëntokë dhe i parkut shplodhës” Bashkia Vlorë.

. Proçedura e ndjekur për të përgatitur këtë raport sizmik është e ndarë në këto dy faza:

1) përcaktimi i **kategorisë së truallit** të sheshit të ndërtimit (në bazë të EC 8) me anë të metodës gjeofizike **MASW** (Multichannel Analysis of Surface Waves)

2) si edhe vlerësimin probabilitar të rrezikut sizmik të sheshit të ndërtimit

Si vlera të PGA janë marrë vlerat e PGA sipas njësive administrative publikuar nga Instituti i Gjeoshkencave Tiranë.


Bazuar ne VKM nr 1162, 24/12/2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”.



Foto. Gjate realizimit te matjes ne terren

Metoda sismike aktive MASW

Në këtë studim kemi përdorur metoden MASW (**M**ultichannel **A**nalysis of **S**urface **W**aves) e cila është një metode studimi jo-invazive që mundeson përcaktimin e profilit të shpejtësisë së valëve tërthore V_s . Kjo metodë bazohet në matjen e valëve sipërfaqësore të bëra nëpërmjet sensorëve të ndryshëm të vendosur në sipërfaqen e tokës. Kontributin mbizotërues në valët sipërfaqësore e japin valët Rayleigh, që transmetohen me shpejtësi e cila është në korrelacion me fortësinë e truallit ku vala kalon. Vetia themelore e valëve sipërfaqësore të Rayleigh, mbi të cilën bazohet analiza për përcaktimin e V_s , është fenomeni i dispersionit që manifestohet në mjedisin e shtresëzuar.



Sinjale sismike që evidencojnë (në të kuqe) valët sipërfaqësore të Rayleigh në një mjedis jo të shtresëzuar (majtas) dhe në një mjed të shtresëzuar (djathtas). Duket shumë qartë fenomeni i shpërndarjes (dispersionit) të valëve sipërfaqësore të Rayleigh në një mjedis të shtresëzuar,


Përpunimi i të dhënave

Analiza MASW mund të përmbliidhet në katër faza:

- ✓ Faza e parë përfshin transformimin e serive kohore në fushë frekuence f - numri valor k .
- ✓ Hapi i dytë është identifikimi i çifteve $f - k$ që i korrespondon energjia maksimale spektrale (dendësi spektrale) për gjetjen e kurbës së dispersionit të valëve Rayleigh në planin V_{fase} (m / sek) – frekuenca (Hz).
- ✓ Faza e tretë konsiston në llogaritjen e kurbës teorike të dispersionit nëpërmjet llogaritjes të profilit të shpejtësisë së valëve vertikale tërthore V_s ,

duke përshtatur e modifikuar trashësinë h , shpejtësitë e valëve tërthore V_S dhe gjatësore V_p dhe dendësinë ρ e shtresave që përbëjnë modelin e truallit.

- ✓ Hapi i katërt dhe të fundit përbëhet nga një modifikimin e kurbës teorike deri në arritjen e një mbivendosje optimale midis shpejtësisë fazore eksperimentale (ose kurba e shpërndarjes) dhe shpejtësisë fazore numerike (ose kurbë dispersionit) që korrespondon me modelin e truallit.



Shpejtësia e valëve Rayleigh në funksion të frekuencës (majtas) dhe profili i shpejtësisë së valëve tërthore në funksion të thellësisë (djathtas) përfituar nëpërmjet procesit të inversionit.

Modeli jep si rezultat vlerën e V_{s30} ekuivalent, të llogaritur në bazë të raportit:

$$V_{s30} = \frac{30}{\sum_{i=1}^{30} \frac{h_i}{V_i}} \quad \text{ku:}$$

V_{s30} = Shpejtësia mesatare e përhapjen e valëve S brenda 30 metra të thellë

h_i = trashësia e shtresës së i -të

V_i = shpejtësia e valëve S të shtresës i -të

N = numri i shtresave të pranishme brenda 30 metrave të para

Për përpunimin e të dhënave u përdor programi **winMasw 7.1 Standard** i *ELIOSOFT – geophysical software & services*.

Pajisjet dhe konfigurimet gjeometrike të përdorura

Pajisjet që janë përdorur për këtë studim janë: Sizmografi DoReMi i Sara Instruments Pg (Italy), 16 gjeofonë vertikale (P) me një frekuencë vetjake e 4.5 Hz; si burim energjie është përdorur vare me peshë 10 kg.

Caratteristiche tecniche

Classe strumentale:	sismografo multicanale per geofisica
Topologia:	rete differenziale RS485 half-duplex multipunto
Lunghezza max rete:	virtualmente illimitata con l'uso di ripetitori
N. max canali per tratta:	255
Dimensioni elemento:	80x55x18 mm
Peso:	250 g (per elemento con cavo di 5 metri)
Cavo:	per geofisica 1x2x0.5 + 1x2x0.25 twisted pair schermato
Memoria:	60 kBytes (30000 campioni)
Frequenze selezionabili:	da 500 a 20000 Hz (passi di campionamento da 2 a 0.05 ms)
Convertitore:	tipo SAR a 16 bit (96 dB)
Amplificatore:	ultra-low noise con ingresso differenziale
Banda passante:	2Hz - 200Hz
Reiezione modo comune:	>80dB
Diافonia (crosstalk):	zero, la trasmissione è digitale
Dinamica del sistema	
Risoluzione:	7.6 μ V @ 27dB; 0.076 μ V @ 60dB
Dinamica di base:	96dB (16 bit)
S/N ratio fra 0.5 e 30Hz:	>94dB (> 150dB con l'uso del PGA)
Alimentazione	
Alimentazione:	batteria ricaricabile interna operativa 10-15Vdc
Consumo di energia:	Interfaccia 80 mA, canale 30mA per una stringa da 12 canali: < 500mA



Klasifikimi i truallit sipas EC8

Në përputhje me përcaktimet e EC 8, ndikimi i konditave lokale të trojeve në veprimin sizmik mund të merret parasysh duke konsideruar shtatë klasa trualli ndërtimor: **A, B, C, D, E, S1** dhe **S2**.


Në përputhje me keto kërkesa për klasifikimin e trojeve sipas **EC8** dhe bazuar në parametrat llogaritur mund të vlerësojmë parametrin **Vs30**

Me anë të metodës MASW -> $V_{S30} = 261$ m/sek.

-Sipas EC 8, mjedisi gjeologjik në këtë shesh ndërtimi klasifikohet i Klasës **C**.

Depozitime te thella me rere te ngjeshur ose gjysme te ngjeshur, zhavorr ose argjile e ngurte, me trashesi nga disa dhjetra metra ne disa qindra metra.

Në fig. më poshtë jepet kurba e ndryshimit të Vs në sheshin e ndërtimit si edhe vlerat e parametrin Vs30:



Vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik të sheshit të ndërtimit

Vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik për konditat e shkëmbit të fortë për sheshin e ndërtimit të kësaj strukture për të dy kushtet e performancës:

1. “kushtin e dëmtimeve të kufizuara” (me probabilitet tejkalimi 10% në 10 vjet, periudhë përsëritje 95 vjet)
2. “kushtin e mos-shëmbjes” (me probabilitet tejkalimi 10% në 50 vjet, periudhë përsëritje 475 vjet),

bazohet në rekomandimin e ofruar nga IGJEO-i (Instituti i Gjeoshkencave) për rrezikun sizmik në këtë shesh ndërtimi, në zbatim të VKM Nr. 1162, datë 24/12/2020 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare 10/2021 në 20 Janar 2021

Vlerat e rrezikut sizmik për këtë shesh ndërtimi, për të dy nivelet e performancës janë:

	PP=95 vjet	PP=475 vjet
PGA	0.154*g	0.317*g

Rreziku sizmik per Bashkine Vlore

Eurokodi 8 përshkruan dy spektra të veçantë projektimi për të marrë në konsideratë rrezikun sizmik në zonat me sizmicitet të lartë dhe të ulët.

- Tipi 1 i spektrit përshkruan rrezikun në zonat me sizmicitet të lartë. Kodi rekomandon të përdoret Tipi 1 i spektrit nëse tërmetet që kontribuojnë më shumë në rrezikun sizmik kanë magnitudë të valëve sipërfaqësore, M_s më të madhe se 5.5.
- Tipi 2 i spektrit rekomandohet nëse tërmetet që kontribuojnë më shumë në rrezikun sizmik kanë magnitudë të valëve sipërfaqësore, M_s më të vogël se 5.5.

Kategorite e trojeve	S	TB (s)	TC (s)	TD (s)
A	1.00	0.15	0.40	2.00
B	1.20	0.15	0.50	2.00
C	1.15	0.20	0.60	2.00
D	1.35	0.20	0.80	2.00
E	1.40	0.15	0.50	2.00

Vlerat e parametrave që përshkruajnë Tipin 1 të spektrave elastikë horizontalë të reagimit sipas EC8

Të dhënat mbi sizmotektonikën dhe sizmicitetin e zonës së Bashkisë Vlore dhe rajonit përreth sugjerojnë ndodhjen e tërmeteve me magnitudë më të madhe se 5.5.

Kështu, spektrat e projektimit për objektin në fjale për të dy nivelet e performancës janë llogaritur duke marrë parasysh se Tipi 1 i spektrave përfaqëson në mënyrë të përshtatëshme rrezikun sizmik në vendin e projektit.


Spektri	avg/ag	TB (s)	TC (s)	TD (s)
Tipi 1	0.90	0.05	0.15	1.00
Tipi 2	0.45	0.05	0.15	1.00

Vlerat e parametrave që përshkruajnë Tipin 1 të spektrave elastikë vertikalë të reagimit sipas EC8

Llogaritja e spektrave elastik horizontal dhe vertikal

Parametrat sizmik, të llogaritur, që rekomandohen për projektin e objektit në këtë shesh ndërtimi, janë përdorimi i kurbave spektrale elastike horizontale e vertikale të normalizuara sipas **EC8**:

- Për kushtin e dëmtimeve të kufizuara PP=95 vjet



Spektrat elastike horizontal dhe vertikal PP=95 vjet

Spektri elastik horizontal i reagimit sipas EC8 (Janar 2004) në truall të Tipit C për kushtin e dëmtimeve të kufizuara; Forma 1 e spektrit;

$$ag \cdot S = 0.177g$$

ku $ag = 0.154g$;

Faktori i Rendesise 1.0;


$S = 1.15$ ($S = S_s \cdot S_T$ vlera e $S_T = 1$ dhe $S_s = 1.15$)

Spektri elastik vertikal i reagimit sipas EC8 (Janar 2004) për kushtin e dëmtimeve të kufizuara; Forma 1 e spektrit;

$$avg = 0.139g$$

- Per për kushtin e mos-shëmbjes PP=475 vjet

Spektri elastik horizontal i reagimit sipas EC 8 ne truall te Tipit E per kushtin e demtimeve te kufizuara; Forma 1 e spektrit;



Spektrat elastike horizontal dhe vertikale PP=475 vjet

$$a_g \cdot S = 0.365 \cdot g$$

ku $a_g = 0.317 \cdot g$;

Faktori i Rendesise-1.0;

$S = 1.15$ ($S = S_s \cdot S_T$ vlera e $S_T = 1$ dhe $S_s = 1.15$)

Spektri elastik vertikal i reagimit sipas EC8 (Janar 2004) per kushtin e mos - shembjes; Forma 1 e spektrit;

$$a_{vg} = 0.285 \cdot g$$

Përfundime dhe rekomandime

1. Trualli në sheshin e zhvillimit të projektit në fjale klasifikohet i Tipit **C** sipas Eurokodit 8 me **$V_{s30} = 261 \text{ m/sek}$**

2. Vlerat e nxitimit maksimal janë:

- për “kushtin e mos-shëmbjes” (me probabilitet tejkalimi 10% në 50 vjet, periudhë përsëritje 475 vjet), kemi vlerën **$PGA=0.365 \cdot g$** .
- për “kushtin e dëmtimeve të kufizuara” (me probabilitet tejkalimi 10% në 10 vjet, periudhë përsëritje 95 vjet) kemi vlerën **$PGA=0.177 \cdot g$** .

Si bazë për këtë vlerësim është pranuar rekomandimi i IGJEUM-it për vlerësimet probabilitare të rrezikut sizmik në territorin e Shqipërisë (IGJEUM, 2021).

3. Për kushtin e “mos-shëmbjes” për spektrin elastik vertikal të projektimit, nxitimi projektues të merret **$avg=0.285 \cdot g$** .

4. Për kushtin e “dëmtimeve të kufizuara” për spektrin elastik vertikal të projektimit nxitimi projektues të merret: **$avg=0.139 \cdot g$** .

5. Llogaritjet e spektrave horizontalë dhe vertikalë sipas Eurokodit 8 janë kryer duke patur parasysh **Tipin 1** të spektrit sipas EC8.

6. Në këtë analizë Faktori i Rëndësisë sipas EC8, është marrë i barabartë me 1.0.
Duke patur parasysh rëndësinë e godinës, rekomandoj që projektuesit e strukturave në këtë projekt të aplikojnë Faktor Rëndësie më të madh se 1.0.

Mbetem në dispozicion për çdo sqarim të mundshëm.

Inxhinier Gjeofizik

Ilir Sera

REFERENCA:

Aliaj, Sh., Koçiu S., Muço B., Sulstarova E. (2010) "Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vleresimi I rrezikut sizmik në -Shqipëri" Tiranë 2010

Aliaj, Sh. (1998) "Neotectonic Structure of Albania". *AJNTS*, NR.4, Tiranë.

Aliaj, Sh., Adams, J., Halchuk, S., Sulstarova, E., Peci, V., Muco, B. (2004) "Probabilistic Seismic Hazard Maps for Albania", 13th, *World Conference on Earthquake Engineering*, Vancouver, B.C., Canada, August 1-6, 2004, Paper No. 2469.

Ambraseys, N. N., Douglas, J., Sarma, S. K., Smit, P (2005). "Equations for the Estimation of Strong Ground Motions from Shallow Crustal Earthquakes Using Data from Europe and the Middle East: Horizontal Peak Ground Acceleration and Spectral Acceleration", *Bulletin of Earthquake Engineering*, Vol.1.3, No. 1, pp. 1-53.

Duni, Ll., Kuka, N. (2003) "Diskutim mbi koeficientet e sizmicitetit dhe spektrat e reagimit te Kodit aktual KTP-N.2-89 në vendin tone", *Revista "Ndërtuesi"*, Nr. 9, Dhjetor 2003, pp.16-20.

Eurocode 8 (2003) "Design of structures for earthquake resistance; Part 1: General rules, seismic actions and rules for buildings", Draft No. 6; Version for translation (Stage 49), Doc CEN/TC250 /SC8/N335, European Committee for Standardization, January 2003, pp. 1-30.

Kuka, N., Sulstarova, E., Duni, Ll., Aliaj, Sh. (2003) "The use of spatial seismicity approach for the evaluation of seismic hazard of Albania", in *Book of abstracts of SE 40EEE*, Skopje-Ohrid, 26-29 August 2003, on CD, pp. 8.

Altin Karriqi, DISERTACION Tema: MIKROZONIMI SIZMIK I QENDRËS SË TIRANËS (Për marrjen e gradës Doktor i Shkencave) Tirane 2016

IGJEUM Hartat probabilitare të rrezikut sizmik dhe vlerat e tyre për çdo njesi administrative, 2021

VKM nr 1162, dt 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi"

<http://georgioudakis.com/software/ec8-spectrum-calculator>

SHTOJCA N°1

Tipet e truallit sipas EC8

Tipi i truallit	Përshkrimi i profilin stratigrafik	Parametrat		
		$v_{s,30}(m/s)$	N_{SPT} (goditje/30cm)	c_u (kPa)
A	Shkëmb ose formacion tjetër gjeologjik i ngjashëm me shkëmbin, duke përfshirë të shumtën 5m material të dobët në sipërfaqe	> 800	–	–
B	Depozita me rërë shumë të ngjeshur, zhavorr ose argjilë shumë të ngurtë, të paktën me disa dhjetëra metra trashësi, të karakterizuar nga një rritje graduale e karakteristikave mekanike, me rritjen e thellësisë	360–800	>50	>250
C	Depozitime të thella me rërë të ngjeshur, ose gjysmë të ngjeshur, zhavorr ose argjile të ngurtë, me trashësi nga disa dhjetëra në disa qindra metra	180–360	15–50	70–250
D	Depozitime tokash të palidhura deri gjysmë të pa-lidhura (me ose pa disa shtresa të buta lidhëse kohezive), ose depozitime tokash që në masën mbizotëruese janë të buta (të dobëta) deri në të forta, të lidhura	< 180	<15	<70
E	Një profil toke (trualli) që ka një shtresë sipërfaqësore aluvionesh me vlera vs të tipit C dhe D dhe trashësi që ndryshon midis rreth 5m dhe 20m, e vendosur mbi një material të ngurtë mbështetës me vs > 800 m/sek			
S1	Depozitime që kanë ose përmbajnë një shtresë prej të paktën 10m trashësi-argjila/lymra të buta me tregues (indeks) të lartë plasticiteti (PI > 40) dhe nivel të lartë ujërash nëntokësore	< 100 (tregues, përcaktues që duhet respektuar)	–	10–20
S2	Depozitime tokash (trojesh) të lëngëzueshme, prej argjilash të ndjeshme (të dobëta) ose me çdo profil tjetër tokë (trualli) që nuk përfshihet në tipet A-E ose S1			

+

SHTOJCA N°2

Faktorët e amplifikimit topografik sipas EC8

Kat.	Sipërfaqja topografike e terrenit		S_T
a	Për sipërfaqe me pjerrësi $i < 15^\circ$		1.0
b	Për sipërfaqe me pjerrësi $i > 15^\circ$	Skarpatet dhe shpatet e izoluara	1.2
c	Kurrizet dhe kreshtat me lartësi mjaft më të vogël se gjerësia në bazë dhe me $15^\circ < i < 30^\circ$	Për zonën pranë majës së sipërfaqes së pjerrët	1.2
d	Kurrizet dhe kreshtat me lartësi mjaft më të vogël se gjerësia në bazë dhe me $30^\circ < i$	Për zonën pranë majës së sipërfaqes së pjerrët	1.4

Shënim 1: Për rastin e shtresave të palidhura, vlera më e vogël e S_T dhënë më sipër duhet të rritet me 20%;

Shënim 2: Ndryshimi në hapësirë i faktorit të amplifikimit. Vlera e S_T mund të supozohet duke u zvogëluar në mënyrë lineare me raportin e lartësisë dhe gjerësisë në bazë të shkrepit ose kreshtës duke marrë si vlerë fillestare atë të bazës.

Forma e spektrit të reagimit elastik jepet e njëjtë për të dy nivelet e veprimit sizmik, që u referohet përkatësisht gjendjeve për kërkesën e mos-shembjes (gjendja e fundit kufitare – veprimi sizmik projektues) dhe për kërkesën e kufizimit të dëmtimeve.

SHTOJCA N°3

Vlorë	→ Vlorë	0.154	0.317
	Orikum	0.156	0.315
	Qëndër Vlorë	0.157	0.320

PGA sipas njësive administrative (burimi I te dhenave IGJEO)

SHTOJCA N°4

CATEGORIA SOTTOSUOLO NTC08															
METODO SEMPLIFICATO															
H-Vs30	100	180	360				800	>800	m/s						
0,00 m	E/S1	E	E	S2				A							
3,00 m															
20,00 m								S1/S2	S2		S2				
30,00 m	D/S1	D	C	B											
>30,00 m															

Skema e klasifikimit të truallit duke përdorur metodën e thjeshtëzuar të NTC08 (Roma Vitantonio e modifikuar)



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

RELACION ARKITEKTONIK

OBJEKTI: “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor Vlorë”

Klienti:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

HARTOI

ARCHISPACE sh.p.k


iRI.shpk

SPHAERA.shpk



INFORMACION BAZE - POZICIONI GJEOGRAFIK

Zona e marrë në studim ndodhet përgjatë rrugës “Çamëria”, e cila përkon dhe me hyrjen e Lungomares. Nderkohe, parcela ndodhet rreth 1.9 km larg qendres së Vlorës.



Pozicioni gjeografik i parces ne lidhje me qytetin e Vlorës

KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE PARCELES DHE ZONES

Vlora është një nga destinacionet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, e njohur për bregdetin e saj magjepsës, historinë e pasur dhe peizazhet mahnitëse. Gjatë sezonit veror, qyteti përjeton një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve, që shpesh shumëfishon popullsinë lokale dhe sjell një ndikim të drejtpërdrejtë në infrastrukturën urbane, përfshirë sistemet e transportit dhe parkimit. Kjo ndërhyrje synon të përmirësojë kapacitetet e parkimit në Vlorë, veçanërisht në zonat me frekuentim të lartë, duke lehtësuar lëvizjen dhe qarkullimin e mjeteve.

Aktualisht territori ka një konfigurim të hapur të shtruar me beton në trajtën e një piazze.



Evidentimi i parceles së propozuar për rikonceptim në lidhje me kontekstin urban ekzistues

ZGJIDHJA ARKITEKTONIKE E PROPOZUAR

Pas studimit dhe vlerësimit të opsioneve më të përshtatshme duke optimizuar në këtë mënyrë synimin e projektit u propozua projektimi i një parkimi nëntokësor me 1 kat nëntokë.



Planvendosja e objektit te propozuar

Zgjidhja funksionale dhe hapësirat – për të optimizuar deri në maksimum hapësirën për vendparkime, plani i katit -1 do të shërbeje vetem për poste parkimi dhe hapësira teknike për depot e ujit. Përsa i përket ambienteve ndihmëse (tualetet) ato do të pozicionohen ne kuotën e katit 0.


Të dhënat e sipërfaqeve

- Siperfaqja e parceles 9557.76 m²
- Siperfaqeja e katit -1 9235.98 m²


Struktura – Objekti do te ndërtohet me strukture beton-arme.

Plani i katit -1-

Poste parkimi totale	295
Poste parkimi PAK	5
Poste parkimi automjete elektrike	6




Planimetria e katit -1



Planimetria e katit -1_Zonimi funksional

Aksesi për në parkim do të realizohet në anën perëndimore të parcelës, e cila do të jetë e pajisur me dy rampa të dedikuara njëra për hyrje dhe tjetra për dalje. Përsa i përket lëvizjes vertikale të këmbësorëve është përlogaritur pozicionimi i 4 kafaze shkallësh emergjence dhe 4 ashensorë. Shkallët janë të projektuara kundra zjarrit me dalje direkte në katin përdhe.




Plan sistemimi_Zonimi Funksional

Përsa i përket zgjidhjes së hapësirës së katit përdhe propozohet krijimi i një strukture strehe në skajin perëndimor të parceles, ku do të akomodohen dhe hapësirat mbështetëse (tualetet) si dhe parkimi i biçikletave. Kjo zgjidhje është menduar e tillë pikërisht për të ruajtur trajtën ekzistuese në formë sheshi, i cili mund të shfrytëzohet sërish për aktivitete të ndryshme recreative, koncerte edhe pas nderhyrjes.



Përsa i përket hapësirës teknike dhe mbështetëse është parashikuar implementimi i funksioneve si mëposhte:


Nyje higjeno-sanitare M	15.17m ²
Nyje higjeno-sanitare F	25.3m ²
Nyje higjeno-sanitare PAK	5.6m ²

Shtrimi I sheshit do të realizohet me të njëjtën rifiniture me shtrimin ekzistues. Më konkretisht rifinitura do te jete shtrim betoni te prere me sharr çdo 3 m me pllaka graniti 100x100cm të implementuara ne të.




SQUARE LAYOUT DETAIL / DETAJ I SHTRIMIT TE SHESHIT




[illegible][illegible]

EAST FACADE/ FASADA LINDORE



WEST FACADE/ FASADA PERENDIMORE




Pamje 3-Dimensionale















RAPORT TEKNIK

PROJEKTI KONSTRUKTIV I NDERTIMIT TË OBJEKTIT

“Ndërtim i Godinës së Parkimit Nëntokësor ,Vlorë”

Ing. Dhimitri Papa

Lic. Nr.1510/2

Tirane, 2025

PERMBAJTJA:

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME


- 1.1. Vendndodhja e objektit
- 1.2. Pershkrimi i Struktures se Objektit
- 1.3. Te dhena gjeologjike dhe sizmike te bazamentit
 - 1.3.1. Gjeologjia e zones
 - 1.3.2. Shtresat perberese te bazamentit
 - 1.3.3. Aktiviteti sizmik
- 1.4. Vetite fiziko-mekanike te materialeve
 - 1.4.1. Celiku i betonarmese
 - 1.4.2. Betoni
 - 1.4.3. Rezistencat

2. MODELIMI 3D I STRUKTURAVE

- 2.1. Principet e modelimit 3D
- 2.2. Imputet e modelit
 - 2.2.1. Ngarkesat Llogaritese Ne Projekt
- 2.3. Analiza dhe rezultatet mbi modelin llogarites

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME

1.1. Vendndodhja e Objektit



1.2. Pershkrimi i Struktures se Objektivit

OBJEKTI : “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor ,Vlorë”

Objekti “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor ,Vlorë” përfaqëson një objekt me 1 kat nën tokë. Destinacioni kryesor i tij është ai i parkimit si edhe ambientet teknike të infrastruktures së MEP.

Struktura është konceptuar me konstruksion mbajtes me rama beton arme dhe mure beton arme në perimetër (EC8 - Frame System), ku ngarkesa sizmike përballëhet kryesisht nga kolonat beton arme. Objekti i jep prioritet të dy drejtimeve perpendikulare për garantimin e zhvendosjeve të lejuara nga veprimet e ngarkesave të jashtme, kryesisht atyre sizmike. Elementet konstruktive janë llogaritur dhe dimensionuar nën veprimin e ngarkesave maksimale të mundshme sipas kombinimit të ngarkesave.

Gjatë procesit të analizës të kësaj ndërtese, është vendosur, që struktura të modelohet me programin e avancuar kompjuterike, **ETABS ULTIMATE C 21.0.0**.

Objekti është një strukturë beton arme e pa ndarë me fuge.

Themeli është projektuar si pllakë themeli ($H_{pl} = 30 \text{ cm}$, $H_{pl} = 70 \text{ cm}$). Përmasimi i pllakës është bërë në funksion të ngarkesave përkatëse dhe vetive fiziko mekanike të bazamentit në të cilin mbështet.

Kolonat, janë projektuar me prerje tërthore ovale kryesisht me përmasë $b \times h = 90 \times 40 \text{ cm}$.

Muret, perimetrale ose të brendshme janë kryesisht me trashësi $t=30 \text{ cm}$.

Traret, janë projektuar me prerje tërthore drejtkëndore kryesisht me përmasë $b \times h = 100 \times 30 \text{ cm}$, $b \times h = 100 \times 20 \text{ cm}$, $b \times h = 70 \times 40 \text{ cm}$.


Soletat, janë realizuar monolite me trashësi $t=30 \text{ cm}$ në mbulesën e katit nëntokësor dhe monolite me trashësi $t=20 \text{ cm}$ në mbulesën e katit përde.

1.3. TE DHENA GJEOLOGJIKE DHE SIZMIKE TE SHESHIT TE NDERTIMIT

1.3.1. Gjeologjia e zones

Per sheshin e ndertimit te objektit ne fjale dhe per qellime te projektimit te ndertesave me destinacion sherbime komerciale mbi kete shesh, jane perdorur te dhena te marra nga studimi “RAPORT MBI KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE TË SHESHIT TË NDËRTIMIT “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor,Vlorë ”

1.3.2. Shtresat perberese te bazamentit



Bazuar në të dhënat e marra në terren janë bërë ndarjet e shtresave sipas ndodhjes së objektit në Bashkinë Vlorë. Nisur në skemën e objektit janë kryer testime për studimin e truallit me testet DPT, e cila bazohet në reagimin e konit të penetrimit gjatë zhytjes në dhera nga goditjet standarte NDPT në thellësi DPT1 = 15 m e DPT2 = 12 m, DPT3 = 13 m dhe DPT4 = 15m, dhe është vlerësuar sekuenca depozicionale duke ndarë shtresat sipas litologjisë dhe karakteristikave gjeoteknike të tyre. Thellësia e ujit është kapur tek DPT1 = 3.8 m. Në bazë të studimit të kryer në sheshin e ndërtimit theksojmë se ka kushte te komplikuar Gjelogo-Inxhinierike për ndërtime.

Nga llogaritjet e kryera sipas programit kompjuterik të kombinuara me vrojtimet në terren jane arritur të evidentohen katër shtresa të cilat janë:

Shtresa e parë: Tokë vegjetale me ngjyrë gri, e karakterizuar nga një strukturë e dendur dhe e ngjeshur. Thellësia në:

DPT1 (0.0 m deri 1.30m)

DPT2 (0.0 m deri 1.20 m)

DPT3 (0.0 m deri 1.20 m)

Tabela 1. Parametrat gjeoteknik për shtresën e parë

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Dendësia relative Dr (%)	79,3	95,7	81,4	85,5
Këndi fërkimit të brendshëm (°)	28,1	30,8	28,4	29,1
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	1,58	1,72	1,59	1,6
Moduli deformimit të drenuar M (kg/cm ²)	81,5	117,7	84,9	94,7
Moduli deformimit i Yungut E (kg/cm ²)	241,8	290,8	246,9	259,8
Moduli deformimit në prerje G₀ (T/ m ²)	6442	9108	6695	7415,0
Shpejtësia e valës sizmike Vs (m/sek)	148,7	158	149,3	152,0
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,4	3,3	2,5	2,7
N_{spt}	11,5	16,6	12	13,4
(qc/pa) / N ₆₀	4,2	4,0	4,2	4,1
Treguesi i sjelljes së dherave Ic	2,3	2,5	2,3	2,4

Tabela 2. Parametrat gjeoteknik për shtresën e dytë

	Prova 1	Prova 2	Prova 3	Mesatarja
Indeksi konsistencës Ic	0,62	0,69	0,71	0,7
Kohezioni pa drenim Cu (kg/cm ²)	0,75	0,86	0,91	0,8
Pesha vëllimore γ (T/m ³)	2	2,04	2,05	2,0
Moduli i deformimit pa drenim Ed (kg/cm ²)	55,7	64,5	68,1	62,8
Moduli i prerjes dinamike G₀ (T/ m ²)	9174	10292	10734	10066,7
Kapaciteti mbajtës Q_{amm} (kg/cm ²)	2,4	2,23	2,37	2,3
Presioni i punës në rrjetin e brendshëm sigurohet nga vetë rrjeti publik i ujësjellësit. Funksionimi i sistemit bazohet në furnizimin e drejtpërdrejtë të përdoruesve fundorë, pa nevojë për ngritje mekanike të presionit dhe pa qarkullim të veçantë të ujit të ngrohtë sanitar, për aq kohë sa në objekt nuk është parashikuar rrjet i centralizuar i ujit të ngrohtë.

Kjo skemë siguron:

- furnizim të thjeshtë dhe funksional për ngarkesën e parashikuar të objektit;
- shpërndarje të drejtpërdrejtë të ujit në pikat e konsumit;
- mirëmbajtje të thjeshtë të rrjetit;
- ndërhyrje teknike të kufizuara dhe funksionim ekonomik të sistemit.

2.5 Përfundime Teknike

Sistemi i furnizimit me ujë për objektin e parkimit dhe parkut shlodhës në Vlorë:

- garanton furnizim të drejtpërdrejtë dhe funksional me ujë në të gjitha ambientet e shërbimit;
- realizohet nga rrjeti publik i ujësjellësit, pa depozitë akumulimi, pa grup pompimi dhe pa impiant trajtimi uji;
- përdor pajisje dhe materiale të përshtatshme për instalime të ujit sanitar dhe për kontakt me ujë të pijshëm;
- përfshin elementë mbrojtës kundër rrjedhës së kthyer në rrjetin publik;
- është i përshtatur për ngarkesat reale të barit dhe blloqeve të tualeteve;
- ofron mirëmbajtje të thjeshtë dhe funksionim praktik të sistemit.

3. Sistemi i Prodimit të Ujit të Ngrohtë Sanitar (DHW)

Për objektin “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor dhe i parkut shplodhës, Vlorë”, uji i ngrohtë sanitar prodhohet **decentralizuar me bojlerë elektrikë**, pa rikuperim nxehtësie.

- **Bar-i** furnizon lavamanët e shërbimit dhe të pastrimit nga **bojler elektrik akumulativ**.
- **Blloqet e WC-ve** (femra/meshkuj) mund të kenë vetëm ujë të ftohtë; nëse kërkohet ujë i ngrohtë për lavamanë, parashikohet **bojler elektrik kompakt** i dedikuar.
- **WC PAK** do të ketë furnizim me ujë të ngrohtë për lavamanin, nga **bojleri më i afërt** (bar ose njësi e veçantë kompakte).
- **Biblioteka: nuk** ka nje hidrosanitare.

Sistemi nuk përdor qark recirkulimi; shpërndarja është **lokale** me linja të shkurtra për të minimizuar humbjet.

3.1. Zgjidhjet e aplikuara me bojler elektrik

Bar (zona shërbimi)

- **Bojler akumulativ:** 80–100 L, 1.5–2.0 kW, 230 V/50 Hz, IPX4.
- **Pikat e shërbimit:** lavaman bar, lavaman pastrimi.
- **Instalimi:** montim mural, valvul sigurie 8 bar, valvul mbyllëse DN15, **toka** e dedikuar 16 A.
- **Tubacione:** PPR PN20; izolim termik në linjën e ujit të ngrohtë.

WC femra / WC meshkuj

- **Bazë:** furnizim me **ujë të ftohtë** (WC me kazë, urinoarë, lavamanë).
- **Opsional ujë i ngrohtë për lavamanë** (nëse kërkohet nga projekti/operimi):
 - **Bojler kompakt** 30–50 L, 1.2–1.5 kW, 230 V/50 Hz, IPX4.
 - Valvul sigurie 8 bar; pikë elektrike 16 A me tokëzim.

WC PAK

- **Ujë i ngrohtë** për lavamanin nga:
 - bojleri i barit (nëse distanca $\leq 10\text{--}12\text{ m}$), **ose**
 - **bojler kompakt** 30–50 L i dedikuar në zonën e WC PAK.
- Pajisje ergonomike (leva njëpikëshe), rubinet me **mbyllje/aktivizim të lehtësuar**.

Bibliotekë

- **Pa** pajisje hidrosanitare; nuk lidhet me rrjetin DHW.

3.2. Skema përmbledhëse e DHW

Zonë funksionale	Lloji i sistemit	Burimi energjisë	Pajisja kryesore	Vërejtje
Bar	Individual (lokal)	Elektrike	Bojler 80–100 L, 1.5–2.0 kW	Furnizon lavaman bar + pastrim
WC Femra	Individual (opsional)	Elektrike	Bojler 30–50 L (nëse kërkohet)	Në bazë vetëm ujë i ftohtë
WC Meshkuj	Individual (opsional)	Elektrike	Bojler 30–50 L (nëse kërkohet)	Në bazë vetëm ujë i ftohtë

Zonë funksionale	Lloji i sistemit	Burimi energjisë	Pajisja kryesore	Vërejtje
WC PAK	Individual	Elektrike	Bojler 30–50 L ose nga bojleri i barit	Ujë i ngrohtë i detyrueshëm për lavaman
Bibliotekë	—	—	—	Pa nyje hidrosanitare

Parametrat e vendosjes:

- Temperatura e daljes DHW: **45 °C** (± 2 K).
- Valvul sigurie **8 bar** në çdo bojler; **valvul mbyllëse** në hyrje të çdo njësie.
- Linjat e ujit të ngrohtë me **izolim termik** të vazhduar.
- **Pa recirkulim**; rrugëzime të shkurtra për kohë të ulët pritjeje.

Kërkesa elektrike dhe siguria

- Çdo bojler: **qark i dedikuar 230 V**, 16 A, me **tokëzim** sipas **EN 60335-2-21**.
- **Mbrojtje IPX4** dhe ndalim i kontaktit uhor mbi pajisje elektrike.
- Ndërprerës diferencial (RCD) i zonës sanitare, sipas projektit elektrik.

Standardet e referencës

- **EN 806-2 / EN 806-3** – Furnizimi me ujë për përdorim njerëzor (projektim/ekzekutim).
- **EN 1717 / UNI 9182** – Parandalimi i kthimit të ndotjes (anti-backflow).
- **EN 15316-3 / EN 15316-5** – Performanca e sistemeve të ngrohjes së ujit.
- **EN 60335-2-21** – Siguria e pajisjeve elektrike për ngrohjen e ujit.
- **ErP 812/2013** – Eficienca energjetike e ngrohësve të ujit.

3.3 Cilësia & Kontrolli

- Të gjitha **tubat, pajisjet, valvulat, armaturat dhe bojlerët** të jenë të **identifikuar** me prodhuesin, modelin dhe **standardet** përkatëse; të shoqërohen me **katalogë** dhe **fletë-teknike** për **miratim**.
- Materialet të vijnë nga fabrika me **sistem cilësie ISO 9001**; produktet do të kenë **certifikim të palës së tretë** për përputhje me standardet (p.sh. CE, deklaratë konformiteti).
- Kur përdoren prodhime lokale, mund të kërkohet **testim i pavarur laboratorik** për përputhje me standardin.

4. SHKARKIMET

4.1 Përshkrimi i Përgjithshëm

Sistemi i shkarkimit të ujërave të ndotura për objektin

“Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor dhe i parkut shplodhës, Vlorë”

është projektuar si **sistem gravitetal me rrjedhje të lirë (self-drainage system)**, në përputhje me kërkesat e **EN 12056-2**, **EN 752**, dhe **DIN 1986-100**.

Rrjeti përbëhet nga:

- Shkarkimet e ujërave të ndotura (ujëra të zeza) nga blloqet e tualeteve dhe bari;
- Shkarkimet e ujërave të pastra (lavamanë, bojlerë, etj.);
- Rrjeti i drenazhimit të parkimit nëntokësor;

- Kolektorët kryesorë të ujërave të ndotura që derdhen në linjën komunale ekzistuese të kanalizimit.

Për shkarkimin e **ujërave atmosferike dhe drenazhimit të parkimit**, janë përdorur **pileta dhe gropa mbledhëse** (sump pits) me **pompim automatik të dyfishtë (duplex pump system)**, të pajisura me sistem alarmi niveli sipas datasheet “Data_sheet_48503_EN.pdf”.

4.2 Parimi i Punës

Të gjitha linjat e brendshme funksionojnë me **gravitacion**, ndërsa grumbullimi i ujërave në pikat e ulëta (parkim dhe puse drenazhimi) realizohet përmes **pompave elektrike** që ngritin ujin drejt kolektorit kryesor të jashtëm.

Rrjeti ndahet në tre nën-sisteme kryesore:

1. Rrjeti sanitar i ambienteve të shërbimit

- WC femra, WC meshkuj dhe WC PAK janë të lidhura në kolona vertikale DN110, që derdhen në kolektorin horizontal DN160 në katin e parkimit.
- Lavamanët, urinoarët dhe pikat e pastrimit kanë linja individuale Ø50–Ø75 mm, të lidhura me kolonën përkatëse.
- Bar-i lidhet me linjë sanitare të dedikuar (lavaman bar, lavaman pastrimi) Ø50–Ø75 mm.

2. Rrjeti i drenazhimit të parkimit

- Parkimi nëntokësor është i pajisur me **pileta dysHEMEJE** (gullies) të tipit Cassel ose të barasvlerëshme, të vendosura në pika me pjerrësi natyrale për grumbullimin e ujërave sipërfaqësore.
- Uji mbledhet në një **pusëtë drenazhi** prej betoni me volum ~0.8 m³, ku janë instaluar **dy pompa elektrike (1+1 rezerva)** me kapacitet 15–18 m³/h secila, me ndezje automatike përmes **flote** dhe **paneli kontrolli elektrik**.
- Pompat derdhin ujin në kolektorin e jashtëm PE100 DN110–DN160.

3. Rrjeti i ujërave atmosferike

- Ujërat nga sipërfaqet e jashtme (sheshi i parkut shlodhës) mbledhen përmes pusetave të shiut dhe derdhen në kanalizimin ekzistues të bashkisë.
- Piletat janë të pajisura me grila gize të klasës **D400** (EN 1433) dhe me sifon kundër erërave.

4.3 Përmasimi

Dimensionimi i rrjeteve sanitare dhe drenazhuese është bërë në përputhje me **EN 12056-2** dhe **DIN 1986-100**, duke respektuar kriteret e mëposhtme:

- **Shpejtësia minimale e rrjedhës:** 0.7 – 1.0 m/s
- **Shpejtësia maksimale e rrjedhës:** 3.0 m/s
- **Pjerrësia e tubave horizontale:** 1.5 – 2.0 %
- **Filling ratio (h/d):** 0.5 – 0.8
- **Diametrat tipikë të përdorur:**
 - Lavamanë, urinoarë → Ø50 mm
 - WC → Ø100 mm
 - Kolona vertikale → DN100–DN110 mm
 - Kolektorë horizontalë → DN125–DN160 mm
 - Kolektor drenazhi → DN160–DN200 mm

Në çdo dalje drejt pusit apo pompës janë vendosur **valvula kundër kthimit (non-return valve)** për të shmangur rikthimin e ujit në rast përmytjeje.

4.4 Ventilimi dhe kontrolli i presionit

- Sistemi është **vetëventilues** për shkarkime me lartësi ≤ 4.0 m, ndaj nuk kërkon kolona të veçanta ventilimi.
- Për WC-të dhe lavamanët me gjatësi horizontale > 6 m, vendosen **valvula ajrimi (AAV)** sipas EN 12380.
- Të gjitha kolonat mbarojnë me **ventilim në tarracë (DN75–DN110)** për barazim presioni me atmosferën.

4.6 Avantazhet e zgjidhjes

- Funksionim gravitetal i thjeshtë dhe i sigurt, pa presione negative.
- Kosto e ulët operimi dhe mirëmbajtjeje.
- Përdorim materialesh rezistente ndaj agentëve kimikë dhe nxehtësisë.
- Siguri në përmytje përmes sistemit të pompimit automatik të ujërave të parkimit.
- Integrim i plotë me sistemin e kanalizimit ekzistues bashkiak.

4.7 Standardet dhe referencat teknike

- **EN 12056-2** – Sistemet e shkarkimit të ujërave të ndotura brenda ndërtesave
- **DIN 1986-100** – Kanalizime të brendshme dhe të jashtme
- **EN 752** – Kanalizimet e jashtme me gravitet
- **EN 1519-1 / EN 1451-1** – Tubacione plastike për ujëra të ndotura
- **EN 12666 / EN 13476** – Kanalizime plastike nëntokësore
- **EN 1433** – Grila dhe kanale kullimi për zona të trafikut
- **VDI 4100** – Akustika e kanalizimeve në ndërtesa

Ky konfigurim siguron **shkarkim të qëndrueshëm, mbrojtje ndaj rikthimit të ujërave, drenazhim efikas të parkimit, dhe funksionim të sigurt** gjatë gjithë ciklit të jetës së objektit.



Tubat e shkarkimit që do të përdoren në ambientin e jashtëm janë tuba PP të valëzuar, me specifikimet teknike të mëposhtme:



4.8 Pajisje tubash

Për lidhjen e **tubave të shkarkimit** me njëri-tjetrit, si dhe me **pajisjet sanitare** (WC, lavamanë, urinoarë, lavaman pastrimi), do të përdoren **fitingje origjinale** të sistemit të kanalizimeve prej **polipropileni (PP)** ose **polietileni të dendur (PE-HD)**, në përputhje me standardet **EN 1451-1**, **EN 1519-1**, dhe **EN 12056-2**.

Këto elemente përfshijnë:

- **Kthesa (bends)** me kënd 45° dhe 87.5° për kalime vertikale/horizontale;
- **Pjesë reduktimi (reducers)** për lidhje midis diametrave të ndryshëm;
- **T-fitingje inspektimi (inspection tees)** për pastrim dhe mirëmbajtje;
- **Kapakë fundorë dhe mufë lidhëse** me unazë gome elastomerike sipas **EN 681-1**.

Të gjitha lidhjet realizohen me **saldim termik, elektrofuzion**, ose me **bashkim elastomerik** (për linjat e parkimit), duke siguruar:

- bashkim **hermetik dhe të qëndrueshëm ndaj presionit**,
- **rezistencë të plotë** ndaj korrozionit dhe agjentëve kimikë,
- **temperaturë funksionimi** deri në **+95 °C**,
- **jetëgjatësi mbi 50 vjet**,
- **zvogëlim të zhurmës** gjatë rrjedhës (< 10 dB(A) sipas **VDI 4100**).

Dimensionet e fitingjeve (diametri nominal, këndi, dhe gjatësia) përcaktohen sipas ngarkesës hidraulike dhe rrjedhës së projektuar të ujërave të ndotura:

- Ø50 mm për lavamanë dhe urinoarë;
- Ø75 mm për lavamanë pastrimi dhe pika shërbimi;
- Ø110 mm për WC dhe kolona vertikale;
- Ø125–160 mm për kolektorët horizontalë kryesorë.

Çdo komponent duhet të jetë i **shënuar qartë** me:

- emrin dhe markën tregtare të prodhuesit,
- **materialin (PP ose PE-HD)**,
- **diametrin nominal (DN)**,
- **vlerësimin e presionit (PN)**,
- **datën dhe serinë e prodhimit**,
duke garantuar gjurmueshmëri dhe përputhje me kërkesat e **CE**.

Në kalimet midis rrjeteve vertikale dhe horizontale përdoren **kthesa të buta (sweep bends 45° + 45°)** për të shmangur turbulencat, goditjet hidraulike dhe grumbullimet e mbetjeve.

Në asnjë rast **diametri i lidhjes nuk duhet të jetë më i vogël** se ai i linjës së kolonës përkatëse.

Ky sistem tubash dhe fittingjesh siguron **rrjedhje të qetë, mirëmbajtje minimale dhe funksionim afatgjatë**, të përshtatshëm për ndërtesa me karakteristika të ngjashme me objektin tonë të parkimit nëntokësor dhe hapësirat e shërbimit në Vlorë.



5. Sistemi i Kullimit të Ujërave Atmosferike

5.1 Përshkrimi i sistemit

Për sistemin e **kullimit të ujërave atmosferike** (tarracat e parkut, sheshet e jashtme, hyrjet e parkimit dhe sipërfaqet e betonit), është projektuar një **sistem gravitetal i hapur**, që funksionon në bazë të pjerrësisë natyrore të dyshemeve dhe mbledhjes së ujit nëpërmjet **pileta kulluese** dhe **puse drenazhi**.

Ujërat e shiut mblidhen në:

- **Pileta PVC/PP të tipit Cassel** ose ekuivalente, me grilë gize të klasës D400 (EN 1433), të vendosura në pikat më të ulëta të shesheve;
- **Puset drenazhi** të betonit të armuar me kapak gize, që shërbejnë si pika grumbullimi për pompim drejt kolektorëve ekzistues të kanalizimit publik.

5.2 Elementët përbërës të sistemit

- **Tuba PVC SN8 ose PE-HD SDR17**, të bashkuara me unazë gome elastomerike sipas EN 681-1;
- **Fitingje (bends, branches, reducers)** për kthesa dhe lidhje të linjave horizontale dhe vertikale;
- **Pileta drenazhi** me kosha filtri çeliku inox AISI 304 dhe sifon kundër erërave;
- **Mbajtëse antivibrim** dhe elementë kompensues për dilatime në linjat horizontale të gjata.

5.4 Dimensionimi

Për llogaritjen e diametrave dhe kapaciteteve është përdorur intensiteti karakteristik i reshjeve për qytetin e **Vlorës**:

$$i = 0.03 \text{ L/s} \cdot \text{m}^2.$$

Sipas kësaj vlere, janë përzgjedhur diametra tipikë:

- **DN 75–110 mm** për tarraca dhe zona të vogla shërbimi;

- **DN 125–160 mm** për sheshet dhe hyrjet e parkimit;
- **DN 200 mm** për kolektorin kryesor të daljes në pusin e pompave.

5.5 Funksionimi dhe siguria

Shpejtësia e rrjedhës është 1.0–2.5 m/s, duke garantuar vetëpastrim dhe funksionim pa depozitime.

Të gjitha linjat horizontale janë me **pjerrësi 1.5–2.0 %** drejt pusetave, dhe përfundimisht derdhen në pusin teknik të parkimit, ku ndodhet grupi i **pompave të ujërave të shiut**.

Në pikat e tranzicionit midis linjave vertikale dhe horizontale përdoren **kthesa të buta 45° + 45°** për të shmangur goditjet hidraulike.

Daljet përfundimtare lidhen me **puset drenazhi** me kapakë gize sipas **EN 124 C250 / D400**.

Ky sistem siguron **rrjedhje të qëndrueshme, siguri hidraulike, dhe mirëmbajtje minimale**, i përshtatshëm për sipërfaqet e betonit dhe parkimin nëntokësor të objektit.

5.6 Kullimi i dyshemeve dhe zonave të lagështa

5.6.1 Materialet dhe karakteristikat e tubacioneve

Tubat e kullimit janë **PVC SN8** ose **PE-HD**, me bashkim nëpërmjet **unazës gome elastomerike** ose **saldim termik**, që siguron lidhje hermetike dhe jetëgjatësi mbi 50 vjet.

Karakteristikat kryesore:

- Rezistencë e plotë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimikë;
- Temperaturë funksionimi deri në +95 °C;
- Sipërfaqe e brendshme e lëmuar për rrjedhje të qëndrueshme;
- Izolim akustik i përmirësuar në kombinim me mbajtëset antivibrim.

5.6.2. Elementët e kullimit dhe piletat e dyshemesë

Në çdo zonë sanitare ose teknike janë parashikuar **pileta dyshemeje** të tipit:

- ___për zona parkimi dhe ambiente shërbimi, me:
 - sifon kundër erërave (trap seal ≥ 50 mm),
 - kapak çeliku inox AISI 304,
 - kosh mbeturinash të heqshëm për pastrim.

Të gjitha piletat përmbushin **EN 1253-1**, me kapacitet rrjedhjeje ≥ 1.2 L/s dhe klasë ngarkese **K3–L15**, të përshtatshme për përdorim publik e teknik.

5.6.3 Vendosja dhe lidhjet

- Piletat vendosen në pikat më të ulëta të dyshemeve me **pjerrësi 1–2 %** drejt grilës.
- Lidhjet me kolonën kryesore realizohen me **kthesa 45° ose 60°**, për të shmangur ngushtimet dhe turbulencat.
- Gjatësia e seksioneve lidhëse ≤ 2 m, me diametra DN 50–100 mm sipas tipit të pajisjes.

5.6.4 Performanca dhe mirëmbajtja

Sistemi garanton:

- Kullim të qëndrueshëm dhe të qetë;
- Rezistencë ndaj ngricës dhe ujërave me ndotje të ulët kimike;
- Mirëmbajtje të thjeshtë, me akses të drejtpërdrejtë për pastrim të piletave.

Ky sistem përmbush plotësisht kërkesat e **EN 12056-2** dhe **EN 1253**, duke ofruar një zgjidhje higjienike, të sigurt dhe me jetëgjatësi të lartë për ambientet e shërbimit dhe parkimin nëntokësor.

6. Kanalet e kullimit

Në pjesën e **ambientit teknik të parkimit** dhe në hyrjet e mjetit zjarrfikës, uji i sipërfaqes do të **drenazhohet përmes ulluqeve gjatësore (linear drains)** prej **betoni ose çeliku inox**, me grila të klasës **D400** sipas **EN 1433**.

Ulluqet janë të lidhura me piletat teknike DN100–DN160 dhe me pusin e pompimit të ujërave të shiut.

Kjo zgjidhje siguron:

- Drenazhim të shpejtë të ujërave gjatë reshjeve intensive;
- Mbrojtje ndaj grumbullimit të ujit në hyrje/ dalje;
- Qarkullim të sigurt për automjetet dhe këmbësorët.




Mbulesa grilë, material gize - GJS-500-7 (GGG).

6.1 Un e plastifikuar (uPVC) Tuba dhe Pajisjet:

Tubat dhe pajisjet e kullimit duhet të kenë ngjyrë kafe dhe të prodhuara nga uPVC në përputhje me BS 4660. Fiksimi i tubit duhet të ketë unaza mbyllëse elastomerike që përputhen me BS 2492. Lubrifikuesi yndyrat e përdorura në bashkim tubacionet dhe pajisje do të të jetë jo toksike.

6.2 Pusetat e mbledhjes së shkarkimeve

Kolektorët e ujit duhet të ndërtohen në përputhje me ulluqet vertikale dhe ne mund të përdorim njësi të tilla për inspektim dhe pastrim të ulluqet në rast se ata janë bllokuar.



7. Testimi i furnizimit me ujë

Pas përfundimit të të gjitha punimeve të instalimeve të furnizimit me ujë, dhe përpara izolimit, mbulimit ose lyerjes së tubacioneve, rrjeti duhet të testohet për papërshkueshmëri nga uji dhe për funksionalitet të plotë. Në rastin e këtij objekti, i cili përbëhet nga **parkim publik në qytetin e Vlorës me grupe tualetesh vetëm në katin përdhe**, furnizimi me ujë realizohet direkt nga **rrjeti publik i ujësjellësit të qytetit**.

Para fillimit të provës, i gjithë rrjeti i furnizimit mbushet gradualisht me ujë, duke lejuar daljen e ajrit nga pikat më të larta të instalimit. Për këtë qëllim, gjatë mbushjes hapen valvulat në pikat terminale dhe në pikat më të larta të rrjetit, në mënyrë që të shmangen xhepat e ajrit dhe të parandalohet goditja hidraulike. Pasi rrjeti të jetë mbushur plotësisht dhe të dalë i gjithë ajri, valvulat mbyllen dhe sistemi bëhet gati për testim.

Testimi kryhet me anë të një pompe prove të lidhur në pikën e përshtatshme të instalimit, zakonisht pas pikës së matjes ose në kolektorin kryesor të furnizimit. Presioni i provës lexohet me manometër dhe mbahet për një periudhë të caktuar kohe. Presioni i testimit duhet të jetë më i lartë se presioni normal i punës, zakonisht **50% deri në 100% mbi presionin e punës**, por jo më i ulët se vlera minimale e kërkuar nga standardet dhe kushtet teknike të zbatimit. Kohëzgjatja e testit duhet të jetë e mjaftueshme për të verifikuar qëndrueshmërinë dhe hermeticitetin e rrjetit.

Nëse gjatë kohës së provës nuk konstatohet rënie presioni në manometër dhe nuk vërehen rrjedhje në asnjë nga nyjet, lidhjet, valvulat apo pajisjet sanitare, atëherë rrjeti konsiderohet i papërshkueshëm dhe i realizuar sipas kërkesave teknike. Nëse konstatohet rënie presioni ose rrjedhje uji, defektet duhet të identifikohen, të riparohen dhe testi të përsëritet deri në arritjen e rezultatit të kërkuar.

Testimi rekomandohet të kryhet në prani të **kontraktorit, mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të investitorit**, dhe pas përfundimit të tij hartohet procesverbali përkatës i testimit.

Pas verifikimit përfundimtar se rrjeti i furnizimit me ujë është funksional, i qëndrueshëm dhe pa rrjedhje, sistemi konsiderohet i gatshëm për t'u vënë në shfrytëzim.

7.1 Testimi Hidraulik i Rrjetit të Furnizimit me Ujë

Pas përfundimit të montimit të plotë të instalimeve të furnizimit me ujë, **përpara mbulimit, izolimit ose lyerjes së tubacioneve**, duhet të kryhet **testimi i papërshkueshmërisë ndaj ujit dhe i funksionalitetit hidraulik** të rrjetit.

Ky test realizohet në përputhje me **EN 806-4** dhe udhëzimet e ujësjellësit lokal (UK Vlora).

Procedura e Testimit:

1. Përgatitja e sistemit:

- Të gjitha nyjet, lidhjet, pajisjet dhe valvulat duhet të jenë të montuara përfundimisht dhe të sigurta.
- Të gjitha pikat e larta të rrjetit duhet të jenë të pajisura me **valvula ajrimi** për nxjerrjen e ajrit gjatë mbushjes.
- Rrjeti duhet të mbushet ngadalë me ujë përmes valvulës kryesore të furnizimit, duke lejuar daljen e ajrit nëpër pikat më të larta.

2. Kryerja e testit të presionit:

- Testimi kryhet me **pompë presioni manuale ose elektrike**, e lidhur menjëherë pas ujëmatësit.
- Presioni i provës duhet të jetë **50–100 % më i lartë se presioni nominal i punës**, por jo më pak se **10 bar** dhe jo më shumë se **15 bar**.
- Rrjeti duhet të mbahet nën këtë presion për **10 deri në 30 minuta**.
- Gjatë testit, presioni monitorohet me **manometër të kalibruar**.
- **Nuk lejohet asnjë rënie presioni** gjatë periudhës së mbajtjes; çdo ulje tregon rrjedhje ose defekt që duhet identifikuar dhe riparuar.

3. Përfundimi i testit:

- Nëse rrjeti ruan presionin gjatë kohës së përcaktuar, ai konsiderohet **i papërshkueshëm nga uji**.
- Në rast rënieje presioni, uji shkarkohet, defekti identifikohet vizualisht dhe testi përsëritet pas riparimit.
- Testimi duhet të kryhet **në prani të përfaqësuesit të Ujësjellësit Komunal, Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit**.
- Pas kalimit të testit, përgatitet një **Procesverbal zyrtar testimi** që nënshkruhet nga të gjitha palët.

7.2 Testimi i Klorifikimit dhe Dezinfektimit të Tubacioneve

Pas përfundimit të testimit hidraulik dhe miratimit të rrjetit, kryhet **dezinfektimi dhe shpëlarja** e plotë e sistemit, në përputhje me **DIN 19630**, **EN 806-4**, dhe udhëzimet e **ISHP** për ujë të pijshëm.

a) Pastrimi paraprak i rrjetit

- Të gjitha tubacionet duhet të pastrohen dhe të shpëlahen përpara dezinfektimit.
- Rrjeti shpëlahet me ujë të pastër nën presion derisa uji i daljes të jetë vizualisht i pastër dhe pa ndotje mekanike.

b) Dezinfektimi me hipoklorit

- Rrjeti mbushet me një **tretësirë dezinfektuese klori** me përqendrim **50–100 mg/L (ppm)**, e përgatitur nga **hipoklorit natriumi (NaOCl)** ose **hipoklorit kalciumi (Ca(OCl)₂)**.
- Të gjitha valvulat dhe pajisjet mbyllen, dhe tretësira lihet të qëndrojë në rrjet për **minimumi 12 orë**.
- Pas periudhës së ekspozimit, rrjeti shpëlahet derisa mbetja e klorit të bjerë **nën 1 mg/L**, dhe uji të plotësojë standardet mikrobiologjike për ujin e pijshëm.

c) Sasia e klorit të nevojshme

Sasia e klorit llogaritet sipas tabelës më poshtë për çdo 100 m tubacion me përqendrim 100 mg/L:

Ø nominal (mm) Klor i lëngshëm (kg) Tretësirë 1% klor (L)

400	1.26	126
300	0.71	71
200	0.31	31
150	0.18	18
100	0.08	8
80	0.05	5
50	0.02	2
25	0.005	0.5

d) Kontrolli dhe certifikimi

- Mostrat e ujit pas shpëlarjes duhet të merren **në pikat fundore të rrjetit** dhe të analizohen nga një **laborator i akredituar (ISHP ose laborator bashkiak)** për:
 - përmbajtje klori të mbetur,
 - praninë e mikroorganizmave (E. coli, enterokokë, koliforme totale),
 - parametra fizikë dhe kimikë.
- Vetëm pas marrjes së rezultateve **brenda kufijve të standardit për ujin e pijshëm**, rrjeti lejohet të vihet në funksionim.

7.3 Dokumentacioni i Testimit dhe Dezinfektimit

Për çdo testim do të përgatitet dokumentacioni zyrtar që përfshin:

- Procesverbalin e testimit të presionit (data, presioni, koha, pajisjet e përdorura);
- Certifikatën e dezinfektimit të nënshkruar nga kontraktori dhe mbikëqyrësi teknik;
- Raportet laboratorike të analizës së ujit;
- Deklaratën e konformitetit të materialeve të përdorura me **EN 10204-2.1** dhe **Direktivën e BE për Ujin e Pijshëm (EU 2020/2184)**.

RELACION TEKNIK I SISTEMIT TE VENTILIMIT TE TUALETIT

Objekti: “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor ,Vlorë ”

Klienti: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Projektues: B.O.E ARCHISPACE shpk & IRI shpk & SPHAERA shpk

Punoi :

Ing. Arta Miraka

Lic M.1374

ing. Ilidon Rapushi

Permbajtja

<i>RAPORT TEKNIK PER VENTILIMIN E TUALETIT</i>	3
<u>1. Hyrje</u>	3
<u>2. Qëllimi i projektit (Purpose of the Project)</u>	3
<u>3. Referenca normative dhe standarde projektimi</u>	3
3.1 Standarde Europiane (EN) – kriteret e performancës	3
3.2 Referenca ndërkombëtare (ASHRAE) – logjika “transfer air + exhaust”	3
3.3 Udhëzime praktike – vendosja e shkarkimit	3
<u>4. Përshkrimi i ambienteve</u>	4
<u>5. Teori projektimi: pse tualetet ventilohen me nxjerrje dhe presion negativ</u>	4
5.1 Ndotësit tipikë dhe “source control”	4
5.2 “Transfer air” si furnizim indirekt	4
5.3 Pse kërkohet thithje e shpërndarë.....	4
<u>6. Koncepti i sistemit</u>	4
6.1 Skema e përgjithshme e punës	4
6.2 Rrjeti i kanaleve (trunk duct + degë flex)	4
<u>7. Grupet e ventilimit dhe rrjetet e projektimit</u>	5
7.1 Grupi 1 – Tualeti i Meshkujve (9 kabina)	5
7.2 Grupi 2 – Tualeti i Femrave + Maintenance (4 kabina + 1 ambient).....	5
<u>8. Kriteria projektimi të rrjetit</u>	5
8.1 Balancimi i degëve.....	5
8.2 Humbjet e presionit dhe zgjedhja e ventilatorit	5
8.3 Shkarkimi final dhe pozicionimi	5
<u>9. Strategjia e operimit</u>	6
<u>10. Testim, balancim dhe pranim</u>	6
<u>11. Përfundime</u>	6

RAPORT TEKNIK PER VENTILIMIN E TUALETIT

1. Hyrje

Ky raport teknik përshkruan zgjidhjen e ventilimit mekanik për blloqet sanitare të objektit: tualeti i meshkujve dhe tualeti i femrave së bashku me ambientin maintenance (brenda të njëjtit bllok). Projekti synon sigurimin e cilësisë së ajrit të brendshëm, kontrollin e aromave dhe lagështisë, si dhe ruajtjen e presionit negativ në zonat sanitare kundrejt zonave të pastra.

2. Qëllimi i projektit (Purpose of the Project)

Sistemi i ventilimit projektohet për të:

- larguar aromat, aerosolët dhe ndotësit higjienikë;
- kontrolluar lagështinë (ulje kondensimi dhe risk myku);
- garantuar drejtim të kontrolluar të rrjedhës së ajrit: zona e pastër → tualet → nxjerrje jashtë;
- ruajtur presion negativ në tualete për të mos përhapur aromat;
- mundësuar balancim dhe verifikim në komisionim (sidomos me trunk duct + degë flex).

3. Referenca normative dhe standarde projektimi

Në projektim përdoren si kuadër referimi standarde/udhëzime të njohura për ventilimin dhe kriteret e mjedisit të brendshëm:

3.1 Standarde Europiane (EN) – kriteret e performancës

- **EN 16798-1:** parametrat e mjedisit të brendshëm dhe metodologjia për vendosjen e kriterëve të projektimit (IAQ, komfort, etj.).
- **EN 16798-3:** kërkesat e performancës për sistemet e ventilimit dhe kondicionimit në ndërtesa jorezidenciale (qasje “performance-based”, projektim/komisionim/operim).
(Referenca më të vjetra si EN 15251 / EN 13779 në shumë raste janë zëvendësuar nga EN 16798.)

3.2 Referenca ndërkombëtare (ASHRAE) – logjika “transfer air + exhaust”

Në praktikë, tualetet projektohen me nxjerrje mekanike, ndërsa ajri i freskët futet si ajër transfer nga zona e pastër (korridor), për të mbajtur presion negativ dhe për të kontrolluar aromat. Kjo filozofi përputhet me qasjet e përdorura në ASHRAE 62.1 për cilësinë e ajrit të brendshëm.

3.3 Udhëzime praktike – vendosja e shkarkimit

Pozicionimi i shkarkimit final duhet të shmangë rikthimin e aromave pranë dritareve/dyerve dhe pranë marrjeve të ajrit të freskët të sistemeve të tjera.

4. Përshkrimi i ambienteve

- Tualet Meshkuj: 9 kabina/pozicione përdorimi.
- Tualet Femra + Maintenance: 4 kabina/pozicione + 1 ambient maintenance (në të njëjtin bllok).

5. Teori projektimi: pse tualetet ventilohe me nxjerrje dhe presion negativ

5.1 Ndotësit tipikë dhe “source control”

Tualetet kanë ngarkesa ndotjeje të veçanta: aromë/VOC, aerosole, lagështi nga lavamanët/pastrimi. Prandaj, strategjia më e mirë është:

1. kapje e ndotësit në burim me thithje të shpërndarë,
2. nxjerrje jashtë (jo riciklim),
3. presion negativ për të mbajtur ndotjen brenda.

5.2 “Transfer air” si furnizim indirekt

Në vend të furnizimit direkt me difuzorë, tualeti merr ajër nga korridori/zonë e pastër përmes:

- hapësirës nën derë (undercut) dhe/ose grilave transferi.
Kjo garanton rrjedhë të qëndrueshme drejt tualetit edhe kur hapet dera.

5.3 Pse kërkohet thithje e shpërndarë

Me vetëm 1 pikë thithjeje, kabinat krijojnë zona të ndenjura. Me grila të shpërndara (dhe degë flex):

- rritet uniformiteti i ventilimit,
- zvogëlohen “xhepat” e aromave,
- përmirësohet perceptimi i higjienës.

6. Koncepti i sistemit

6.1 Skema e përgjithshme e punës

- Ajri hyn në tualet si **transfer** nga zona e pastër.
- Ajri i ndotur merret nga grila thithjeje dhe nxirret jashtë.
- Shkarkimi final vendoset në mënyrë që të mos ketë rikthim aromash.

6.2 Rrjeti i kanaleve (trunk duct + degë flex)

- Kanal kryesor (trunk) mbledh prurjet e degëve.
- Degë flex lidhen me grilat e thithjes për kabinat/zonat.
- Balancimi është kusht i domosdoshëm për të garantuar prurje në pikat më të largëta.

7. Grupet e ventilimit dhe prurjet e projektimit

7.1 Grupi 1 – Tualeti i Meshkujve (9 kabina)

- Ventilator centrifugal tip “kuti”
- Prurja nominale: $Q = 1000 \text{ m}^3/\text{h}$ (siç është kërkuar)
Kjo jep një rend madhësie rreth $110 \text{ m}^3/\text{h}$ për pozicion, e përshtatshme për përdorim të shpeshtë dhe rrjet me rezistencë.

7.2 Grupi 2 – Tualeti i Femrave + Maintenance (4 kabina + 1 ambient)

- Ventilator INLINE kryesor: $Q = 500 \text{ m}^3/\text{h}$
- Rrjet trunk + degë flex për pikat e thithjes (kabina + maintenance).

Interpretim projektimi:

- $500 \text{ m}^3/\text{h}$ mbulon ekstraksionin e përgjithshëm të bllokut Femra+Maintenance dhe synon të ruajë presion negativ.
- Për të garantuar performancë, maintenance duhet të ketë pikë thithjeje të dedikuara (degë e veçantë), që të mos “mbulohet” nga kabinat gjatë balancimit.

Shënim i rëndësishëm inxhinierik: Me 4 kabina + maintenance, $500 \text{ m}^3/\text{h}$ është një prurje e arsyeshme për shumë raste praktike, por verifikimi final duhet të bëhet edhe kundrejt volumit real (ACH) dhe intensitetit të përdorimit.

8. Kритere projektimi të rrjetit

8.1 Balancimi i degëve

Me trunk + flex, balancimi është “kusht performance”:

- çdo degë duhet të rregullohet që të arrijë prurjen e synuar;
- maintenance duhet të ketë degë të dedikuara (që të mos mbetet pa thithje kur kabinat dominojnë).

8.2 Humbjet e presionit dhe zgjedhja e ventilatorit

Ventilatorët centrifugal janë të përshtatshëm kur rrjeti ka:

- shumë degë, kthesa, lidhje flex;
- rezistencë të ndryshueshme (p.sh. rregullime balancimi / ndotje).
Prandaj, zgjedhja për meshkujt është teknologjikisht e drejtë për stabilitetin e prurjes.

8.3 Shkarkimi final dhe pozicionimi

- Shkarkimi i ajrit të ndotur duhet të jetë larg marrjeve të ajrit të freskët, dyerve dhe dritareve.
- Qëllimi është të shmangët “short-circuit” (rikthim i ajrit të ndotur në ndërtesë).

9. Strategjia e operimit

Për tualete rekomandohet:

- operim i vazhdueshëm gjatë orarit të përdorimit të objektit; ose
- operim me timer sipas orarit, me kujdes që të mos lejohet grumbullim aromash.

10. Testim, balancim dhe pranim

Në fazën e dorëzimit kërkohet:

1. matje prurjesh në grilat kryesore të thithjes;
2. balancim i degëve (sidomos degës së maintenance);
3. test praktik i presionit negativ (rrjedhë ajri nën derë/grilë transferi);
4. kontroll i zhurmës/vibrimeve.

11. Përfundime

- Meshkuj: sistem ekstraksioni i dedikuar me ventilator centrifugal 1000 m³/h, i përshtatshëm për rrjet trunk + degë flex dhe ngarkesë të lartë përdorimi.
- Femra + Maintenance: sistem i përbashkët me ventilator INLINE 500 m³/h si ventilatori kryesor, me kërkesë për pikë thithjeje të dedikuar për maintenance dhe balancim të rrjetit për performancë të qëndrueshme.
- Koncepti bazohet në praktikat e mira: transfer air + exhaust, presion negativ, shpërndarje thithjeje dhe shkarkim final të kontrolluar.

RAPORTI I MNZSH

PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN.

Objekti: “Ndërtim i godinës së parkimit nëntokësor ,Vlorë ”

Klienti: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Projektues: B.O.E ARCHISPACE shpk & iRI shpk & SPHAERA shpk

RELACION TEKNIK

- Baza ligjore per projektimin e sistmit te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpetimit
- Pjesë te relacionit arkitektonik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
- Pjesë te relacionit konstruktiv të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
- Pjesë te relacionit mekanik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
- Pjesë te relacionit elektrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
- Pjesë te relacionit hidrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në objekt
- Skenarët hipotetikë
- Masat e menaxhimit
- Numrat e emergjencave

PROJEKTUES:

ERGYS ÇAUSHI

Tiranë 2025

Permbajtja

1. BAZA LIGJORE.....	4
1.1. STANDARDE EUROPANE & NDËRKOMBËTARE PËR MZSH.....	5

2. RELACIONI TEKNIK ARKITEKTONIK DHE URBAN PËR MBROJTJEN NDAJ ZJARRIT	6
2.2. Klasifikimi dhe përshkrimi funksional i objektit	6
2.3. Aksesit i mjeteve zjarrfikëse	7
2.5. Identifikimi i kriterëve sipas lartësisë antizjarr të godinës	9
2.5.1. Lartësi antizjarr	9
2.5.2. Kompartimentet	10
2.5.3. Numri i shkallëve	10
2.5.4. Tipi i kafazit të shkallëve dhe ashensorët	10
2.6. Rrugët e Evakuimit	11
2.6.4. Daljet e sigurisë së brendshme	12
2.6.5. Daljet e sigurisë së jashtme	12
2.6.6. Skema e evakuimit	13
2.7. Distancat e sigurisë	13
2.8. Ventilimi dhe Largimi i Tymrave	15
2.8.1. Tipologjia e sistemit	15
2.8.2. Përbërja e sistemit	15
2.8.3. Kapaciteti i ventilimit	15
2.8.4. Kontrolli dhe siguria e funksionimit	16
2.8.5. Konkluzion	16
2.9. Impiantet e prodhimit të nxehtësisë	18
3. RELACIONI TEKNIK KONSTRUKTIV PËR MBROJTJEN NDAJ ZJARRIT	19
3.1. Rezistenca ndaj Zjarrit e Elementeve Konstruktive (Shkalla REI)	19
3.2. Klasifikimi i Objektit Sipas Rrezikshmërisë nga Zjarri	20
3.3. Përfundime të Kapitullit Konstruktiv	21
A. Karakteristikat e përgjithshme të parkimit	22
B. Materialet ndërtimore dhe reagimi ndaj zjarrit	22
C. Ventilimi dhe kufizimi i tymrave	23
D. Masa shtesë të sigurisë konstruktive dhe pasive	23
E. Konkluzion	23
4. RELACIONI PER PROJEKTIN MEKANIK TE M.N.Z.SH.-SE	24
4.1. Kategoritë e Zjarreve sipas Kateve:	24
4.2. Norma e rritjes së zjarrit:	26
4.3. Karakteristika e shfrytëzimit:	26
4.4. Profili i rrezikut:	27

Kapitulli 4 – Sistemet Teknologjike dhe Masat Shtesë të Sigurisë.....	28
4.5. Substanca të rrezikshme dhe depozitimi i tyre.....	28
4.6. Sistemet teknologjike të shërbimit.....	29
4.7. Zonat me rrezik të veçantë.....	30
4.8. Sistemet fikëse të shuarjes (Shkumë, Pluhur, Gaz CO ₂).....	30
Përfundim.....	30
4.9 TABELA PERMBLEDHESE E PAJISJEVE PER MBROJTJE NDAJ ZJARRIT DHE SHPETIMIT	31
4.10. Skema Horizontale dhe Vertikale e Evakuimit.....	32
Përshkrim i përgjithshëm	32
Skema Horizontale e Evakuimit	32
Skema Vertikale e Evakuimit	32
Daljet e sigurisë dhe pikat e grumbullimit	33
Elementët ndihmës për evakuimin	33
4.11. Sinjalistika Pamore dhe Zanore	33
Pjesa Pamore e Sinjalistikës.....	33
Pjesa Zanore e Sinjalistikës.....	34
Përfundim.....	34
5. RELACION PER PROJEKTIN ELEKTRIK TE M.N.Z.SH.-SE	35
Llojet e ndriçuesve emergjentë	35
Furnizimi dhe autonomia	36
Sinjalistika dhe piktogramet.....	36
Kontrolli dhe mirëmbajtja.....	36
Përfundim.....	36
5.2. Sistemi i detektim dhe sinjalizimit kundra zjarrit.....	37
5.3. Impianti i tokëzimit dhe ekuipotencializimit.....	39
5.3.1. Ndërtimi i Rrjetit të Tokëzimit.....	39
5.3.2. Tokëzimi i Neutrit.....	40
5.3.3. Përçuesit e Rrjetit të Tokëzimit.....	40
5.3.4. Lidhjet Ekuipotencializuese	40
5.3.5. Rrjeti i Mbrojtjes nga Shkarkimet Atmosferike (LPS)	41
6. RELACION PER PROJEKTIN HIDRIK TE M.N.Z.SH.-SE	41
6.1. Kriteret percaktuese	41
6.2. Përbërja e sistemit hidrik	42
6.3. Ambienti teknik i pompave të mbrojtjes ndaj zjarrit	42

6.4. Grupi i Pompimit i Sistemit Sprinkler	45
6.5. Grupi i Pompimit i Sistemit të Hidranteve.....	45
6.5. Rezervuari i Ujit për Sistemet MNZ	46
6.6. Kushtet e Ambientit Teknik.....	46
6.7. Masat e Sigurisë dhe Mirëmbajtja	46
7. SKENARË HIPOTETIKË TË ZJARRIT DHE REKOMANDIMET PËR MBROJTJE EFEKTIVE	47
8. MASAT E MENAXHIMIT TË SIGURISË SIPAS NIVELIT TË PERFORMANCËS	50
9.NUMRAT E EMERGJENCAVE	57

1. BAZA LIGJORE

- **Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 425 datë 24.07.2015**
Për “Pranimin, Administrimin e Dokumentacionit Teknik dhe Grafik të Projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin dhe Lëshimin e Aktëve Teknike”
- **Shenjat Konvencionale dhe Treguese të Dokumentacionit Teknik dhe Grafik të Projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin**

- **Ligji Nr.152, datë 21.12.2015**
“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”
 ✓ Neni 39 – Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin
 ✓ Neni 40 – Detyrimet e hartuesit të projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.162 datë 19.04.1965**
Për miratimin e “Rregullores mbi masat mbrojtëse kundra zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji”
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 626, datë 15.07.2015**
Për Miratimin e Normativave të Projektimit të Banesave - Kapitulli X “Standardet kombëtare të projektimit ALS-P-MKZ (ALBANIAN STANDARDS – PROJEKTIMI – MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT – 2015/01)”
- **Urdhëri i Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 424 datë 24.07.2015**
“Për Miratimin e Rregullave Teknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin në Ndërtesat me Destinim për Banim”
- **Urdhëri i Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit Nr. 445 datë 09.04.2004**
Për miratimin e rregullores “Për masat e mbrojtjes nga zjarri në depo dhe magazina të ndryshme”
- **Urdhëri Nr. 27 datë 16.01.2017**
Për klasifikimin e objekteve sipas dënueshmërisë dhe rrezikshmërisë ndaj zjarrit
- **Vendim Nr.699, datë 22.10.2004**
Për miratimin e rregullores teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në “ndërtesat me destinim të ndryshëm, shërbime përfshirë apartamente akomoduese turistike”
- **Urdhër Nr. 1199, datë 26.10.2016**
Rregullore e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në forcat e armatosura
- **Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015**
Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit
- **Vendim Nr. 457, datë 29.6.2022**
Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar

1.1. STANDARDE EUROPANE & NDËRKOMBËTARE PËR MZSH

- **SSH EN 12845:2015+A1:2019**
 Sisteme fikse të mbrojtjes nga zjarri – Sistemet me spërkatje automatike – Projektimi, instalimi dhe mirëmbajtja
- **SSH EN 671:2012**
 Sistemet zjarrfikëse të palëvizshme – Sistemet e tubave
- **SSH EN 3**
 Fikësit portativë të zjarrit
- **SSH EN 12101:2020**
 Sistemet e kontrollit të tymit dhe të nxehtësisë
- **BS 7346**
 Components for smoke and heat control systems

- **UNI 10779:2021**

Impianti di estinzione incendi – Reti di idranti – Progettazione, installazione ed esercizio

2. RELACIONI TEKNIK ARKITEKTONIK DHE URBAN PËR MBROJTJEN NDAJ ZJARRIT

Ky seksion përshkruan detajet arkitektonike të projektit për të siguruar përputhjen e tij me kërkesat e mbrojtjes pasive ndaj zjarrit dhe shpëtimit.

Prona që do të zhvillohet ndodhet në qytetin e **Vlorës**, në një zonë urbane me infrastrukturë të konsoliduar dhe me qasje të drejtpërdrejtë në rrugë publike.

Objekti i projektuar është një **Parkim Publik nëntokësor** me një **kat nën nivelin e tokës (-1)** dhe me **pjesën e sipërme të mbuluar me hapësira të gjelbëruara dhe kalime pedonale**, pa ndërtime të tjera mbi të.

Ky parkim është konceptuar si strukturë e mbyllur, me sipërfaqe totale ndërtimi prej **rreth 7 800 m²**, dhe lartësi të lirë **2.95 m**, duke respektuar kërkesat për qarkullim të mjeteve, ventilim mekanik dhe siguri zjarri.

Objekti kufizohet nga rrugë publike në të paktën dy drejtime, duke mundësuar **akses të drejtpërdrejtë të mjeteve zjarrfikëse** për ndërhyrje në rast emergjence. Hyrja dhe dalja e mjeteve realizohet nëpërmjet **një rampe të vetme** të projektuar për qarkullim dykahësh, ndërsa evakuimi i njerëzve sigurohet përmes **katër shkallëve emergjente** që lidhin katin nëntokësor me nivelin e tokës.

Pozicionimi i objektit, largësitë nga ndërtimet përreth dhe gjatësia e rrugëve të aksesit janë në përputhje me **kërkesat e VKM nr. 626, datë 15.07.2015** dhe **Udhëzimin nr. 425, datë 24.07.2015**, duke garantuar distancat e nevojshme për:

- kalimin dhe manovrimin e mjeteve zjarrfikëse;
- sigurimin e aksesit në pikat kryesore të ndërhyrjes;
- krijimin e korridoreve të hapura për ventilim natyral ndihmës dhe shkarkim tymrash në rast emergjence.

2.2. Klasifikimi dhe përshkrimi funksional i objektit

Objekti në studim është një **Parkim Publik nëntokësor** i ndodhur në qytetin e **Vlorës**, në afërsi të **Universitetit “Ismail Qemali”** dhe **Pallatit të Kulturës “Labëria”**, me dalje të drejtpërdrejtë në **Rrugën “Kosova”**.

Ndërtimi është i përbërë nga një **kat i vetëm nëntokësor (-1)**, ndërsa pjesa e sipërme është **shesh i gjelbëruar dhe pedonal**, pa ndërtime të tjera mbi të.

Ky parkim është projektuar si strukturë e mbyllur, me **sipërfaqe ndërtimi 7 800 m²** dhe **lartësi të lirë 2.95 m**, duke respektuar të gjitha kërkesat për qarkullim automjeteve, ventilim të detyruar dhe mbrojtje ndaj zjarrit sipas **VKM nr. 626, datë 15.07.2015, Udhëzimit nr. 425, datë 24.07.2015 dhe Urdhrit nr. 81, datë 06.03.2020.**

Karakteristikat kryesore të objektit

- **Kate:** 1 kat nëntokësor (-1)
- **Funksion:** Parkim publik për automjete, me ambiente teknike ndihmëse
- **Sipërfaqe ndërtimi:** 7 800 m²
- **Lartësi kati:** 2.95 m
- **Kapacitet parkimi:** rreth 230 poste automjeteve
- **Sistemi konstruktiv:** betonarme, me ndarje në fasha strukturore të ventilueshme
- **Sistemi i mbrojtjes nga zjarri:** sprinklerë automatikë, hidrante të brendshëm, sistem ventilimi mekanik për largim tymrash, ndriçim emergjent dhe sinjalistikë evakuimi.

Pozicionimi dhe distancat mbrojtëse

Objekti është i pozicionuar në një parcelë të rrethuar nga ndërtime ekzistuese publike dhe shërbimesh, me distancat mbrojtëse si më poshtë:

- **Në jug:** ndodhet godina e Universitetit “Ismail Qemali”, e cila është rreth 20 m larg sheshit të parkimit;
- **Në veri:** ndodhet Restorant “Al Porto”, në një distancë prej rreth 38 m nga kufiri i objektit;
- **Në lindje:** përballë kufizohet me rrugën publike “Kosova”, nga e cila realizohet hyrja në parkim; distanca nga rruga kryesore deri te rampa është rreth 200 m;
- **Në perëndim:** ndodhet Pallati i Kulturës “Labëria”, në një distancë prej rreth 32 m nga kufiri ndërtimor.

Këto distanca sigurojnë mbrojtje të plotë ndër-objektesh dhe krijojnë korridore të qarta ndërhyrjeje për mjetet zjarrfikëse dhe zonat e ventilimit ndihmës, në përputhje me kërkesat e mbrojtjes nga zjarri për ndërtesat e tipit “parkim publik nëntokësor”.

2.3. Akseset dhe mjeteve zjarrfikëse


Aksesi për mjetet zjarrfikëse është i siguar nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues, duke respektuar kriteret e Udhëzimit nr. 425/2015 dhe VKM nr. 626/2015 për ndërhyrje në raste emergjence.

- **Akses kryesor:** nga Rruga “Kosova”, e cila shërben si korridor qarkullimi dhe vendosjeje për mjetet zjarrfikëse.
- **Distanca nga hyrja e parkimit:** rreth 200 m nga kthesa pranë godinës së Universitetit “Ismail Qemali”.

- **Rampa hyrëse/dalëse:** lidh nivelin e tokës me katin nëntokësor (−1), me pjerrësi të projektuar për kalimin e automjeteve zjarrfikëse të lehta në rast kontrolli ose ndërhyrjeje.
- **Distancat për rrethim dhe manovrim:**
 - Në jug – hapësirë e lirë 20 m midis parkimit dhe godinës së Universitetit.
 - Në veri – distancë 38 m nga Restorant “Al Porto”.
 - Në perëndim – 32 m nga Pallati i Kulturës “Labëria”.
 - Në lindje – rrugë publike 9 m e gjerë për akses direkt.

Rrugët përreth parkimit dhe sheshi i gjelbër mbi të sigurojnë **akses të plotë për vendosjen e mjeteve zjarrfikëse**, me **distancë maksimale ≤ 40 m nga çdo pikë e ndërhyrjes**.

Evakuimi i personave është i garantuar përmes **katër shkallëve emergjente**, të shpërndara në mënyrë të baraspeshuar në plan, me dalje të sigurta në sipërfaqe të hapur në nivelin 0



Legjenda

Shenime:

- Shkalla “R” për rezistencë ndaj zjarrit për elementet e jashtëm konstruktiv është R120.
- Numri maksimal i personave që evakuhohen është 125 për derë me gjerësi 1m, referuar VKM Nr. 162, datë 19/04/1965, Neni 29.
- Autoriteti zjarrfikës mund të ndërhyjë në dy ane të objektit.

F.D.

E drejta e hyrjes së mjeteve zjarrfikëse

Gjeresia e rruges, pjerrësia dhe rrezet e kthimit plotesojne kriteret e nevojshme sipas Urdhërit të Ministrit Punëve të Brendshme Nr. 424 datë 24.07.2015, paragrafi 7, përshkruar më poshtë:

- Gjeresia: 3,50 m;
- Lartësia e lire: 4,00 m;
- Rrezja e kthimit: 13,00 m;
- Pjerrësia: jo më shumë se 10%;
- Rezistenca ndaj peshes: të paktën 20 ton (8 në të aksin e përparmë dhe 12 në të aksin e prapmë; hapi 4,00 m).

2.5. Identifikimi i kriterëve sipas lartësisë antizjarr të godinës

2.5.1. Lartësi antizjarr Referuar kuotës së pozicionimit të mjeteve zjarrfikëse me kuotës së aksesit te katit me të sipërm të banueshëm duke konsideruar lartësinë e dritares apo parapetit e ballkonit, rezulton +0.0 m.

Ref. UMPB nr.dt . 24.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim”, sipas lartësisë antizjarr godinat klasifikohen si tipi (A).

Tipi i ndërtësës	Lartësia antizjarr e ndërtësës	Sipërfaqja maksimale e ambienteve në (m²)	Sipërfaqja maksimale (m²) e katit që i përkon një shkalle në ndërtësë	Tipi i kafazit të shkallëve dhe të paktën një kafaz për ashensor	Karakteristikat “REI” të kafazit të shkallëve dhe ashensorit, të filtrit të tymit, të dymit, të elementeve e ndarjeve në kate
a	Mbi 12 deri 24 m	8 000	500	Asnjë përcaktim	60 (**)
			500	Të paktën të mbrojtura n.q.s. nuk përmbushen kërkesat e pikës 7.2.	60
			550	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	60
			600	E provës së tymit	60
b	Mbi 24 deri 32 m	6 000	500	Asnjë përcaktim	60 (**)
			500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm n.q.s. nuk përmbushen kërkesat e pikës 7.2.	60
			550	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	60
			600	Të provës së tymit	60
c	Mbi 32 deri 54 m	5 000	500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm	90
d	Mbi 54 deri 80 m	4 000	500	Të paktën të provës së tymit të brendshëm me filter të ventilimit jo më të vogël se 0.36 m².	90
e	Mbi 80 m	2 000	350(*)	Të paktën të provës së tymit të brendshëm me filter të ventilimit jo më të vogël se 0.36 m².	120

Tab. Klasifikimi I tipit të ndërtësës sipas lartësisë antizjarr

2.5.2. Kompartimentet

Sipas VKM nr. 626, datë 15.07.2015 dhe Udhëzimit nr. 425, datë 24.07.2015, sipërfaqja maksimale e një kompartimenti të vetëm në ndërtesa të kategorisë “Parkim nëntokësor publik” nuk duhet të kalojë **8 000 m²**.

Objekti ynë, **Parkimi Publik Vlorë**, ka një sipërfaqe totale prej **7 800 m²**, e cila është e ndarë funksionalisht në **katër zona sprinkler të veçanta (rreth 1 950 m² secila)** me ndarje hidraulike dhe kontroll individual përmes valvulave të zonave.

Për më tepër, kompartimenti ndahet vizualisht dhe konstruktivisht me ndarje strukturore që sigurojnë kufizim të përhapjes së tymit dhe nxehtësisë.

➔ **Ky kusht është i plotësuar**, pasi sipërfaqja efektive e çdo kompartimenti nuk e kalon vlerën 8 000 m² të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

2.5.3. Numri i shkallëve

Sipas Urdhrit nr. 81, datë 06.03.2020 dhe referencave të VKM nr. 626/2015, sipërfaqja maksimale që i përket një shkalle evakuimi nuk duhet të kalojë **500 m² për kat**.
